FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 66

Tiranë – E martë, 31 mars 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 16/2026, datë 12.2.2026	Për disa shtesa në vendimin nr. 65/2025, "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit".....	4987
Vendim i Kuvendit nr. 45/2026, datë 5.3.2026	Për një shtesë në vendimin nr. 65/2025, "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit" ...	4987
Vendim i Kuvendit nr. 47/2026, datë 12.3.2026	Për disa shtesa në vendimin nr. 64/2025, "Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit".....	4987
Vendim i Kuvendit nr. 48/2026, datë 12.3.2026	Për një shtesë në vendimin nr. 65/2025, "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit".....	4988
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 203, datë 30.3.2026	Për emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.....	4988
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 68, datë 17.3.2026	Për caktimin e fushës së përgjegjësisë dhe detyrave të zëvendësministrave për infrastrukturën dhe energjinë.....	4988
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 69, datë 17.3.2026	Për delegim kompetence.....	4989
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 70, datë 17.3.2026	Për delegim kompetence.....	4990
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 71, datë 17.3.2026	Për delegim kompetence.....	4990

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 72, datë 17.3.2026	Për delegim kompetence.....	4991
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 73, datë 17.3.2026	Për delegim kompetence.....	4991
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 85, datë 25.3.2026	Për miratimin e rregulloreve për përcaktimin e rregullave për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", të ndryshuar, në lidhje me menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim.....	4992
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 252, datë 24.3.2026	Për delegim kompetencash.....	5018
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 253, datë 24.3.2026	Për delegimin e kompetencës së përfaqësimit ligjor të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në proceset gjyqësore.....	5018
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 254, datë 24.3.2026	Për caktimin e fushës së përgjegjësisë dhe detyrave për zëvendësministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme.....	5019
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 255, datë 24.3.2026	Për caktimin e fushës së përgjegjësisë dhe detyrave për zëvendësministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme.....	5019
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 256, datë 24.3.2026	Për delegimin e kompetencës së ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi çështjet konsullore.....	5020
Urdhër i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 260, datë 25.3.2026	Për caktimin e fushës se përgjegjësisë dhe detyrave për zëvendësministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme.....	5021
Urdhër i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 63, datë 27.3.2026	Për delegim kompetence.....	5022
Vendim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr. 10, datë 27.3.2026	Për anëtarësimin e Bankës Jet sh.a. në skemën e sigurimit të depozitave dhe dhënien e certifikatës për sigurimin e depozitave	5022
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 131, datë 13.3.2026	Autorizim i ndihmës shtetërore "Mbështetje me grante për zhvillimin të qëndrueshëm në fushat e riciklimit, energjisë së pastër, reduktimit të ndotjes dhe edukimit mjedisor në Bashkinë Tiranë"....	5023
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 46, datë 17.2.2026	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	5026

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 47, datë 17.2.2026	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë "Tirana International Development" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	5028
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 48, datë 17.2.2026	Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 30, datë 4.2.2026, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë 'Breçani - R.O.S.P' sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.1.2022".....	5029
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 49, datë 17.2.2026	Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2026, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë 'Gerti' sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021".....	5030
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 50, datë 17.2.2026	Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 33, datë 4.2.2026, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë 'Gerti' sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 362, datë 7.12.2023".....	5031
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 51, datë 17.2.2026	Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 34, datë 4.2.2026, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë 'Gerti' sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 54, datë 22.2.2021".....	5032
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 52, datë 17.2.2026	Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 38, datë 4.2.2026, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë 'Mountain's Green Energy' sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 283, datë 18.12.2024".....	5033
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 53, datë 17.2.2026	Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 4.2.2026, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë 'Tirana Energji' sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 4.11.2020".....	5035
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 54, datë 17.2.2026	Mbi shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 304, datë 17.11.2025, "Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë 'Proinfinit Consulting' sh.p.k.".....	5036
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 55, datë 17.2.2026	Mbi kërkesën e shoqërisë "3AD Energy" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj "First Investment Bank" sh.a.....	5037
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 69, datë 10.3.2026	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	5038
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 70, datë 10.3.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "GSA" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	5040

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 72, datë 10.3.2026	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet marrëveshjes siguruese) të aseteve fikse të shoqërisë "Nova Solar System" sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj "Raiffeisen Bank" sh.a.....	5041
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 73, datë 10.3.2026	Mbi kërkesën e shoqërisë "EB Energy" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj "Procredit Bank" sh.a.....	5044

VENDIM
Nr. 16/2026

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 65/2025, "PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT"

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 21, pika 1, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I, të vendimit nr. 65/2025, "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit" bëhen këto shtesa:

- Deputetët Arkend Balla dhe Skënder Pashaj caktohen anëtarë zëvendësues në Komisionin për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 12.2.2026.

VENDIM
Nr. 45/2026

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 65/2025, "PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT"

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 21, pika 1, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën XI, të vendimit nr. 65/2025, "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit" bëhet shtesa e mëposhtme:

Deputetja Ilva Gjuzi caktohet anëtare zëvendësuese në Komisionin për Nismat Qytetare, Bashkëpunim dhe Mbikëqyrjen Institucionale.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 5.3.2026.

VENDIM
Nr. 47/2026

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 64/2025, "PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT"

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 21, pika 1, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I, të vendimit nr. 64/2025, "Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit" bëhen këto shtesa:

- Deputeti Pirro Vëngu caktohet anëtar në Komisionin për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm.
- Deputetja Elisa Spiropali caktohet anëtare në Komisionin për Çështjet e Brendshme dhe Mbrojtjen.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 12.3.2026.

VENDIM
Nr. 48/2026

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 65/2025, "PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT"

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 21, pika 1, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën III, të vendimit nr. 65/2025, "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit" bëhet shtesa e mëposhtme:

- Deputeti Pirro Vëngu caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Çështjet e Brendshme dhe Mbrojtjen.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 12.3.2026.

VENDIM
Nr. 203, datë 30.3.2026

PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 56, pikat 1 e 2, e 85, pika 10, të ligjit nr. 82/2024, "Për Policinë e Shtetit", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Skënder Hita emërohet drejtor i përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe i jepet grada "Drejtues madhor".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 68, datë 17.3.2026

PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË DHE DETYRAVE TË ZËVENDËSMINISTRAVE PËR INFRASTRUKTURËN DHE ENERGJINË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 6, pika 2, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit"; të nenit 22 e vijues, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; si dhe vendimit nr. 508, datë 25.9.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë",

URDHËROJ:

1. Zëvendësministri për Infrastrukturën dhe Energjinë, z. Erlind Sulo, ngarkohet të ndjekë, të monitorojë dhe të përgjigjet para ministrit, mbi:

a) sektorin elektroenergjetik, burimeve të rinovueshme dhe eficiencës së energjisë;

b) sektorin e hidrokarbureve dhe zhvillimin e tregut dhe infrastrukturës në këtë sektor;

c) sektorin minerar dhe të gjeologjisë.

2. Zëvendësministri për Infrastrukturën dhe Energjinë, z. Hantin Bonati, ngarkohet të ndjekë, të monitorojë dhe të përgjigjet para ministrit, mbi:

a) planin për energjezimin e administratës, si dhe proceset e digjitalizimit, riinxhinierimit dhe derregullimit të shërbimeve;

b) proceset e ristrukturimit dhe të riorganizimit, sektoriale apo strukturore, si dhe

modernizimit të shërbimeve në të gjitha fushat që janë në përgjegjësi të ministrisë;

c) luftën kundër informalitetit dhe korrupsionit në të gjitha fushat që janë në përgjegjësi të ministrisë;

ç) shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private, duke përfshirë dhe çështjet që lidhen me procedurën dhe mënyrën mbi vlerësimin e objekteve që shpronësohen dhe propozimit për shpronësim në Këshillin e Ministrave.

3. Zëvendësministri për Infrastrukturën dhe Energjinë, znj. Enkelejda Muçaj, ngarkohet të ndjekë, të monitorojë në përbërje të ministrisë dhe të përgjigjet para ministrit mbi:

a) komunikimet elektronike, digjitale dhe postare;

b) masat në kuadër të procesit të integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

4. Zëvendësministri për Infrastrukturën dhe Energjinë, znj. Edona Bilali, ngarkohet të ndjekë, të monitorojë dhe të përgjigjet para ministrit, mbi:

a) ecurinë e realizimit të marrëveshjeve ndërkombëtare;

b) marrëdhëniet me investitorë vendës dhe të huaj që kanë paraqitur interes për të zhvilluar projekte strategjike në fushën e infrastrukturës dhe energjisë;

c) ecurinë e projekteve me financim të huaj, nga faza e konceptimit deri në zbatim;

ç) përfaqësimin e ministrisë në tryeza pune, takime dypalëshe apo shumëpalëshe, si dhe në aktivitete të tjera që lidhen me projektet;

d) sektorin e ujësjellës-kanalizimeve.

5. Zëvendësministri për Infrastrukturën dhe Energjinë kërkon, sa herë që konsideron të nevojshme, informacion nga institucionet e varësisë, agjencitë autonome dhe drejtoritë në shërbim të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, mbi çështjet që janë përcaktuar në këtë urdhër, fushë e përgjegjësisë së tij.

6. Zëvendësministri për Infrastrukturën dhe Energjinë, raporton me shkrim te Ministri për Infrastrukturën dhe Energjinë, për zbatimin e detyrave të caktuara në këtë urdhër, sipas kërkesës së ministrit.

7. Zëvendësministri autorizohet për nënshkrimin e akteve administrative, trajtimin, komunikimin dhe ndjekjen e procedurave zyrtare. Zëvendësministrat e ushtrojnë të drejtën e delegimit sipas fushave të përgjegjësisë të përcaktuara në këtë urdhër.

8. Përveç ndjekjes dhe raportimit të çështjeve, sipas sektorëve përkatës, zëvendësministrat ngarkohen për ndjekjen edhe të çështjeve të tjera të ngarkuara me urdhër të veçantë të ministrit.

9. Urdhri nr. 32, datë 23.1.2026, "Për caktimin e fushës së përgjegjësisë dhe detyrave të zëvendësministrave për infrastrukturën dhe energjinë", i ndryshuar, shfuqizohet.

10. Ngarkohen zëvendësministrat dhe nëpunësit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi

URDHËR
Nr. 69, datë 17.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të ligjit nr. 9000, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, për miratimin dhe nënshkrimin e autorizimeve në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe shkresat përcjellëse drejtuar ministrive homologe, palë në marrëveshje në fushën e transportit ndërkombëtar rrugor, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Hantin Bonati.

2. Z. Hantin Bonati, të ndjekë dhe zbatojë kriteret dhe procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar, dhe pikave 7.5.2 dhe 8.2 të udhëzimit nr. 8, datë 19.12.2019, "Për kriteret, rregullat dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e

veprimtarisë në transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve".

3. Urdhri nr. 13, datë 13.1.2026, i zëvendëskryeministrit dhe i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, "Për delegim kompetence", shfuqizohet.

4. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Hantin Bonati, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi

URDHËR
Nr. 70, datë 17.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, për nënshkrimin e urdhrave të lëshimit të lejeve *(diplomatic clearence)* për hyrjen, uljen e kalimin e mjeteve lundruese ushtarake, të mjeteve fluturuese ushtarake dhe mjeteve të transportit, dhe/ose të blinduara ushtarake të huaja, në hapësirën ajrore, detare dhe territoriale të Republikës së Shqipërisë, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Hantin Bonati.

2. Z. Hantin Bonati të ndjekë dhe zbatojë kriteret dhe procedurat e përcaktuara në vendimin nr. 357, datë 13.6.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e lëshimit të lejeve *(diplomatic clearence)* për hyrjen, uljen e kalimin e mjeteve lundruese ushtarake, të mjeteve fluturuese ushtarake dhe mjeteve të transportit dhe/ose të blinduara ushtarake të huaja, në hapësirën ajrore, detare dhe territoriale të Republikës së Shqipërisë", gjatë ushtrimit të fushës së përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri dhe legjislacionin në fuqi.

3. Urdhri nr. 14, datë 13.1.2026, i zëvendëskryeministrit dhe i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, "Për delegim kompetence", shfuqizohet.

4. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Hantin Bonati, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi

URDHËR
Nr. 71, datë 17.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të ligjit nr. 9000, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, për nënshkrimin e të gjitha akteve që lidhen me procedurat e likuidimit për individët dhe subjektet e shpronësuara, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Hantin Bonati.

2. Z. Hantin Bonati të ndjekë dhe zbatojë kriteret dhe procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private, për interes publik", i ndryshuar, gjatë ushtrimit të fushës së përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri.

3. Urdhri nr. 12, datë 13.1.2026, i zëvendëskryeministrit dhe i ministrit të Infrastrukturës dhe

Energjisë, "Për delegim kompetence", shfuqizohet.

4. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Hantin Bonati, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi

URDHËR
Nr. 72, datë 17.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të shkronjës "d", të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003; "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; dhe të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, për miratimin e organit të vlerësimit të konformitetit, në përputhje me parashikimet në ligjin nr. 10489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", të ndryshuar, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Erlind Sulo.

2. Në ushtrimin e kompetencës së deleguar, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z. Erlind Sulo, ndjek dhe zbaton rregullat dhe procedurat në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Urdhri nr. 39, datë 2.2.2026, i zëvendëskryeministrit dhe i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, "Për delegim kompetence", shfuqizohet.

4. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Erlind Sulo, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi

URDHËR
Nr. 73, datë 17.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të shkronjës "d", të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Erlind Sulo, për nënshkrimin e:

a) aktit të miratimit ose të refuzimit të lejes së kërkimit, zbulimit dhe shfrytëzimit për aplikimet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), për t'u pajisur me leje minerare;

b) njoftimit për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare;

c) njoftimit për ndërprerjen e procedurave të fillimit të revokimit të lejeve minerare;

ç) vendimit për revokimin e lejeve minerare;

d) aktit për pasqyrimin dhe miratimin e ndryshimeve të të dhënave në lejet minerare;

dh) aktit të miratimit ose të refuzimit të lejes së kërkimit, zbulimit dhe shfrytëzimit për zgjatjen e afateve, ndryshimin e koordinatave, transferimin e lejeve minerare;

e) aktit të dhënies së të drejtës së aplikimit në QKB, për zonat e hapura për qëllime publike;

ë) aktit për miratimin e nënkontraktimeve;

f) shkresës së korrespondencës me QKB-në për sektorin minerar;

g) miratimit dhe refuzimit të aplikimeve për autorizimet për personat juridikë, privatë ose publikë, vendës apo të huaj, për përdorim civil të lëndëve plasëse;

gj) urdhrit për kthimin, apo moskthimin e garancive financiare të rehabilitimit dhe të investimit;

h) urdhrit për miratimin e projekteve shtesë të veprimtarive minerare;

i) aktit të njoftimit të pezullimit të lejes së shfrytëzimit me minierë sipërfaqësore të mineraleve dhe të grupit të mineraleve ndërtimore, si dhe për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet.

2. Në ushtrimin e kompetencave të deleguara, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Erlind Sulo, i ndjek dhe i zbaton ato në mbështetje të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, dhe të ligjit nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil", dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, brenda fushës së përgjegjësisë së përcaktuar në këtë urdhër.

3. Kompetencat e deleguara, sipas pikës 1, ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi e këtij urdhri deri në miratimin e një urdhri të dytë.

4. Urdhri nr. 42, datë 2.2.2026, "Për delegim kompetence", i zëvendëskryeministrit dhe i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, shfuqizohet.

5. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Erlind Sulo, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi

URDHËR
Nr. 85, datë 25.3.2026

PËR MIRATIMIN E RREGULLOREVE PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 1095, DATË 24.12.2020, "PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE THELBËSORE NË FUSHËN E AVIACIONIT CIVIL", TË NDRYSHUAR, NË LIDHJE ME MENAXHIMIN E RREZIQEVE TË SIGURISË SË INFORMACIONIT ME NJË NDIKIM TË MUNDSHËM NË SIGURINË NË OPERIM[1]

Në zbatim të pikës 4, neni 102, të Kushtetutës; të pikës 2, shkronjës "ç", neni 7, të nenit 11 dhe nenit 108, të ligjit nr. 96/2020, "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë"; të pikës 3.1(b), shtojca II, të pikës 3.3(b) dhe pikës 5(b), shtojca IV, të pikës 8.1(c), shtojca V, të pikës 2.1.1 dhe pikës 5.2,

[1] Ky urdhër përafron pjesërisht Rregulloren e Komisionit (BE) nr. **2022/1645** e datës 14 korrik 2022 që përcakton rregullat për zbatimin e rregullores (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm mbi sigurinë në operim për organizatat e mbuluara nga Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 748/2012 dhe (BE) nr. 139/2014 dhe që ndryshon Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 748/2012 dhe (BE) nr. 139/2014, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së nr. *L 248, 26.9.2022,* plotësisht rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) **2025/22** e 19 dhjetorit 2024, që ndryshon rregulloren e deleguar (BE) nr. 2022/1645, për sa u takon kërkesave për sigurinë e informacionit të organizatave, që ofrojnë shërbime në tokë, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së nr. *L 2025/22, 7.3.2025, pjesërisht* rregulloren e Komisionit (BE) nr. **2023/203**, e datës 27 tetor 2022, për përcaktimin e rregullave për zbatimin e rregullores (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë e aviacionit për organizatat e mbuluara nga Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 1321/2014, (BE) nr. 965/2012, (BE) nr. 1178/2011, (BE) 2015/340, Rregulloret Implementuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664, dhe për autoritetet kompetente të mbuluara nga Rregulloret e Komisionit (BE) nr. 748/2012, (BE) nr. /2012, (BE) nr. 1178/2011, (BE) 2015/340 dhe (BE) nr. 139/2014, Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664 dhe që ndryshon rregulloret e komisionit (BE) nr. 1178/2011, (BE) nr. 748/2012, (BE) nr. 965/2012, (BE) nr. 139/2014, (BE) nr. 1321/2014, (BE) 2015/340, dhe Rregulloret Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/373 dhe (BE) 2021/664, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së nr. L 31, 2.2.2023, pjesërisht rregulloren (BE) **2024/1109**, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së nr. L, 2024/1109, 23.5.2024, pjesërisht rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) **2023/1769**, të datës 12 shtator 2023 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin ose prodhimin e sistemeve dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror dhe që ndryshon rregulloren zbatuese (BE) 2023/203, botuar në FZ të BE-së L228, 15.9.2023, Rregulloren Zbatuese e Komisionit (BE) **2025/2293**, e datës 10 nëntor 2025, që ndryshon rregulloren zbatuese (BE) 2023/203, në lidhje me kërkesat e zbatueshme për organizatat që i nënshtrohen një deklarate dhe korrigjon rregulloret (BE) nr. 1178/2011, (BE) nr. 748/2012, (BE) nr. 965/2012, (BE) nr. 139/2014, (BE) nr. 1321/2014, (BE) 2015/340 dhe rregulloren zbatuese (BE) 2017/373.

shtojca VII, të pikës 5.1(c) dhe pikës 5.4(b), shtojca VIII, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", të ndryshuar; si dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, "Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe të Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Për përcaktimin e rregullave për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, 'Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar në lidhje me menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat e mbuluara nga urdhri nr. 57, datë 13.3.2024, dhe urdhri nr. 170, datë 13.9.2022', i ndryshuar", sipas shtojcës I që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e rregullores "Për përcaktimin e rregullave për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, 'Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil', i ndryshuar" në lidhje me menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat e mbuluara nga urdhrat nr. 79, datë 15.4.2024, nr. 80, datë 30.6.2023, i ndryshuar; nr. 178, datë 20.12.2023, i ndryshuar; nr. 171, datë 11.11.2025; nr. 193, datë 6.10.2022, i ndryshuar; nr. 119, datë 29.9.2023, dhe për autoritetet kompetente të mbuluara nga urdhrat nr. 57, datë 13.3.2024; nr. 79, datë 15.4.2024; nr. 80, datë 30.6.2023, i ndryshuar; nr. 178, datë 20.12.2023, i ndryshuar; nr. 171, datë 11.11.2025; nr. 170, datë 13.9.2022, i ndryshuar; nr. 193, datë 6.10.2022, i ndryshuar; nr. 119, datë 29.9.2023", sipas shtojcës II që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohet Autoritetit i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi

SHTOJCA I

RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 1095, DATË 24.12.2020, "PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE THELBËSORE NË FUSHËN E AVIACIONIT CIVIL", I NDRYSHUAR, NË LIDHJE ME KËRKESAT PËR MENAXHIMIN E RREZIQEVE TË SIGURISË SË INFORMACIONIT ME NJË NDIKIM TË MUNDSHËM NË SIGURINË NË OPERIM PËR ORGANIZATAT E MBULUARA NGA URDHRI I MINISTRIT NR. 57, DATË 13.3.2024, DHE URDHRI I MINISTRIT NR. 170, DATË 13.9.2022, I NDRYSHUAR

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton kërkesat që duhen përmbushur nga organizatat e përmendura në nenin 2 për të identifikuar dhe menaxhuar rreziqet e sigurisë së informacionit me ndikim të mundshëm në sigurinë në operim, të cilat mund të ndikojnë në sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe të dhënat e përdorura, për qëllime të aviacionit civil dhe për të zbuluar ngjarjet e sigurisë së informacionit, si dhe për të identifikuar ato që konsiderohen si incidente të sigurisë së informacionit me ndikim të mundshëm në sigurinë në operim dhe për t'iu përgjigjur atyre incidenteve të sigurisë së informacionit dhe për t'u rikuperuar nga ato.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Kjo Rregullore zbatohet për organizatat e mëposhtme:

a) organizatat e prodhimit dhe organizatat e projektimit që u nënshtrohen nënpjesëve G dhe J të seksionit A të aneksit I (pjesa 21) të urdhrit të ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për kërkesat e aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit", me përjashtim të organizatave të projektimit dhe prodhimit që janë të përfshira vetëm në projektimin dhe/ose prodhimin e avionëve ELA2, siç përcaktohet në nenin 1(2), shkronja "j" e urdhrit të ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor, ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për kërkesat e aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit";

b) Operatorët e aerodromit dhe ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të vendqëndrimit që i nënshtrohen aneksit III "Kërkesat për organizatën (pjesa-ADR.OR)" të urdhrit të ministrit nr. 170, datë 13.9.2022, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative, që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

c) Organizatat e përpunimit në tokë që i nënshtrohen Rregullores që përcakton kërkesat për ofrimin e sigurt të shërbimeve të përpunimit në tokë dhe për organizatat që i ofrojnë ato, që përafron rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) 2025/20, që:

i. për të ofruar shërbimet përkatëse, duhet të mbledhin, ruajnë, analizojnë ose përpunojnë të dhënat e ofruara nga palët e treta; ose

ii. t'u sigurojnë direkt operatorëve të avionëve të dhënat që do të përdoren për qëllime operacionale.

Parashikimet në këtë shkronjë zbatohen nga data 27 mars 2031, me kusht që rregullorja që përcakton kërkesat për ofrimin e sigurt të shërbimeve të përpunimit në tokë dhe për organizatat që i ofrojnë ato, përafrim i rregullores së deleguar të Komisionit (BE) 2025/20 të ketë hyrë në fuqi.

2. Kjo Rregullore nuk cenon kërkesat e sigurisë së informacionit dhe sigurisë kibernetike të përcaktuara në VKM-në nr. 411, datë 19.6.2024, "Për miratimin e Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil", dhe në legjislacioni në fuqi për sigurinë kibernetike.

Neni 3
Përkufizimet

Për qëllim të kësaj Rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. "Siguria e informacionit" nënkupton ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit, autenticitetit dhe disponueshmërisë së rrjetit dhe sistemeve të informacionit;

2. "Ngjarja e sigurisë së informacionit" nënkupton një ndodhi të identifikuar të një sistemi, shërbimi ose gjendje rrjeti që tregon një shkelje të mundshme të politikës së sigurisë së informacionit ose dështimin e kontrolleve të sigurisë së informacionit, ose një situatë të panjohur më parë që mund të jetë e rëndësishme për sigurinë e informacionit;

3. "Incident" është çdo ngjarje që komprometon disponueshmërinë, vërtetësinë, integritetin, konfidencialitetin e të dhënave të ruajtura, të transmetuara apo të përpunuara, ose të shërbimeve të ofruara apo të aksesueshme përmes rrjeteve dhe sistemeve të informacionit;

4. "Rreziku i sigurisë së informacionit" nënkupton rrezikun për operimet organizative të aviacionit civil, asetet, individët dhe organizatat e tjera, për shkak të potencialit të një ngjarjeje të sigurisë së informacionit. Rreziqet e sigurisë së informacionit shoqërohen me mundësinë që kërcënimet të shfrytëzojnë dobësitë e një aseti informacioni ose një grupi asetesh informacioni;

5. "Kërcënim" nënkupton një shkelje të mundshme të sigurisë së informacionit që ekziston kur ekziston një entitet, rrethanë, veprim ose ngjarje që mund të shkaktojë dëm.

6. "Vulnerabilitet" nënkupton një defekt ose cenueshmëri në një aset ose një sistem, procedura, projektim, zbatim ose masa të sigurisë së informacionit që mund të shfrytëzohen dhe që rezulton në një thyerje ose shkelje të politikës së sigurisë së informacionit.

Neni 4
Kërkesat që dalin nga legjislacioni tjetër kombëtar

1. Kur një organizatë e përmendur në nenin 2 përputhet me kërkesat e sigurisë specifike

kombëtare në lidhje me masat për një nivel të lartë të sigurisë kibernetike që janë ekuivalente me kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore, pajtueshmëria me këto kërkesa sigurie do të konsiderohet se përbën përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore.

2. Kur një organizatë e përmendur në nenin 2 është një operator ose një ent i referuar në programet kombëtare të sigurisë së aviacionit civil të përcaktuara në përputhje me nenin 10 të udhëzimit nr. 26, datë 20.10.2010, "Mbi rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së Aviacionit Civil", kërkesat e sigurisë kibernetike të përfshira në VKM-në nr. 411, datë 19.6.2024, "Për miratimin e Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil", konsiderohen të jenë ekuivalente me kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore, me përjashtim të pikës IS.D.OR.230 të aneksit të kësaj Rregulloreje, e cila duhet të respektohet.

3. Ministri pas konsultimit me Autoritetin e Aviacionit Civil dhe me Autoritetin përgjegjës për Sigurinë Kibernetike, mund të miratojë udhëzime për vlerësimin e ekuivalencës së kërkesave të përcaktuara në këtë Rregullore dhe rregullat kombëtare në lidhje me masat për një nivel të lartë të sigurisë kibernetike.

Neni 5
Autoriteti kompetent

1. Autoriteti përgjegjës për certifikimin dhe mbikëqyrjen e pajtueshmërisë me këtë Rregullore do të jetë:

a) në lidhje me organizatat e përmendura në nenin 2, shkronja "a", autoriteti kompetent i caktuar në përputhje me aneksin I (pjesa 21) të urdhrit të ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor, ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për kërkesat e aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit".

b) në lidhje me organizatat e përmendura në nenin 2, shkronja "b", autoriteti kompetent i caktuar në përputhje me aneksin III (pjesa-ADR.OR) të urdhrit të ministrit nr. 170, datë 13.9.2022, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

c) në lidhje me organizatat e përmendura në nenin 2, shkronja "c", autoriteti kompetent i caktuar në përputhje me aneksin (pjesa-ARGH) të Rregullores, që përcakton rregullat për zbatimin e VKM-së nr. 1095/2020, i ndryshuar, në lidhje me kërkesat për mbikëqyrjen e shërbimeve të përpunimit në tokë dhe organizatave që i ofrojnë ato, që përafron e rregullores zbatuese të Komisionit (BE) 2025/23.

Parashikimet në këtë shkronjë zbatohen nga data 27 mars 2031, me kusht që rregullorja që përcakton rregullat për zbatimin e VKM-së nr. 1095/2020, e ndryshuar, në lidhje me kërkesat për mbikëqyrjen e shërbimeve të përpunimit në tokë dhe organizatave që i ofrojnë ato, përafrim i rregullores zbatuese të Komisionit (BE) 2025/23, të ketë hyrë në fuqi.

2. Në rast se legjislacioni kombëtar, për qëllimet e kësaj Rregulloreje, përcakton një entitet të pavarur dhe autonom për të përmbushur rolin dhe përgjegjësitë e caktuara të autoriteteve kompetente të përmendura në pikën 1, masat e koordinimit do të vendosen ndërmjet atij entiteti dhe autoriteteve kompetente, e përmendura në pikën 1, për të siguruar mbikëqyrje efektive të të gjitha kërkesave që duhet të përmbushen nga organizatat.

ANEKSI
SIGURIA E INFORMACIONIT – KËRKESAT E ORGANIZATËS
[PJESA-IS.D.OR]

IS.D.OR.100	Fushëveprimi
IS.D.OR.200	Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit
IS.D.OR.205	Vlerësimi i rrezikut të sigurisë së informacionit
IS.D.OR.210	Trajtimi i rrezikut të sigurisë së informacionit
IS.D.OR.215	Skema e raportimit të brendshëm të sigurisë së informacionit
IS.D.OR.220	Incidentet e sigurisë së informacionit – zbulimi, reagimi dhe rikuperimi
IS.D.OR.225	Përgjigjja ndaj gjetjeve të njoftuara nga autoriteti kompetent

IS.D.OR.230	Skema e raportimit të jashtëm të sigurisë së informacionit
IS.D.OR.235	Kontraktimi i aktiviteteve të menaxhimit të sigurisë së informacionit
IS.D.OR.240	Kërkesat për personelin
IS.D.OR.245	Ruajtja e të dhënave
IS.D.OR.250	Manuali i menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMM)
IS.D.OR.255	Ndryshimet në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit
IS.D.OR.260	Përmirësim i vazhdueshëm

IS.D.OR.100 Fushëveprimi

Kjo pjesë përcakton kërkesat që duhet të plotësojnë organizatat e përmendura në nenin 2 të kësaj Rregulloreje.

IS.D.OR.200 Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS)

a) Për të arritur objektivat e përcaktuar në nenin 1, organizata duhet të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS), i cili siguron që organizata:

1. vendos një politikë për sigurinë e informacionit duke përcaktuar parimet e përgjithshme të organizatës në lidhje me ndikimin e mundshëm të rreziqeve të sigurisë së informacionit në sigurinë në operim;

2. identifikon dhe rishikon rreziqet e sigurisë së informacionit në përputhje me pikën IS.D.OR.205;

3. përcakton dhe zbaton masat e trajtimit të rrezikut të sigurisë së informacionit, në përputhje me pikën IS.D.OR.210;

4. zbaton një skemë raportimi të brendshëm të sigurisë së informacionit, në përputhje me pikën IS.D.OR.215;

5. përcakton dhe zbaton, në përputhje me pikën IS.D.OR.220, masat e nevojshme për zbulimin e ngjarjeve të sigurisë së informacionit, identifikon ato ngjarje që konsiderohen si incidente me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim dhe u përgjigjet dhe rikuperohet nga këto incidente të sigurisë së informacionit;

6. zbaton masat që janë njoftuar nga autoriteti kompetent si reagim i menjëhershëm ndaj një incidenti ose cenueshmërie të sigurisë së informacionit me ndikim në sigurinë në operim;

7. merr masat e duhura, në përputhje me pikën IS.D.OR.225, për të adresuar gjetjet e njoftuara nga autoriteti kompetent;

8. zbaton një skemë raportimi të jashtëm në përputhje me pikën IS.D.OR.230 për t'i dhënë mundësi autoritetit kompetent të ndërmarrë veprimet e duhura;

9. përputhet me kërkesat e përfshira në pikën IS.D.OR.235, kur kontrakton ndonjë pjesë të aktiviteteve të përmendura në pikën IS.D.OR.200 me organizata të tjera;

10. përputhet me kërkesat e personelit të përcaktuara në pikën IS.D.OR.240;

11. përputhet me kërkesat e mbajtjes së të dhënave të përcaktuara në pikën IS.D.OR.245;

12. monitoron përputhshmërinë e organizatës me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe jep komente mbi gjetjet te menaxheri përgjegjës ose, në rastin e organizatave projektuese, te drejtuesi i organizatës projektuese, me qëllim që të sigurojë zbatimin efektiv të veprimeve korrigjuese;

13. mbron, pa paragjykuar kërkesat e zbatueshme të raportimit të incidentit, konfidencialitetin e çdo informacioni që organizata mund të ketë marrë nga organizata të tjera, sipas nivelit të saj të ndjeshmërisë.

b) Për të përmbushur vazhdimisht kërkesat e referuara në nenin 1, organizata zbaton një proces përmirësimi të vazhdueshëm në përputhje me pikën IS.D.OR.260.

c) Organizata dokumenton, në përputhje me pikën IS.D.OR.250, të gjitha proceset kryesore, procedurat, rolet dhe përgjegjësitë e kërkuara për të qenë në përputhje me pikën IS.D.OR.200(a) dhe krijon një proces për ndryshimin e këtij dokumentacioni. Ndryshimet në këto procese, procedura, role dhe përgjegjësi menaxhohen në përputhje me pikën IS.D.OR.255.

d) Proceset, procedurat, rolet dhe përgjegjësitë e vendosura nga organizata në përputhje me pikën IS.D.OR.200(a) do të korrespondojnë me natyrën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të saj, bazuar në një vlerësim të rreziqeve të sigurisë së informacionit të qenësishme për këto aktivitete dhe mund të integrohen brenda sistemeve të tjera ekzistuese të menaxhimit të zbatuara tashmë nga organizata.

e) Pa paragjykuar detyrimin për të përmbushur kërkesat e raportimit të përfshira në urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, "Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë" dhe

kërkesat e pikës IS.D.OR.200 (a)(13), organizatës mund t'i jepet miratimi nga autoriteti kompetent për të mos zbatuar kërkesat e përmendura në shkronjat "a" deri në "d" dhe kërkesat përkatëse të përfshira në pikat IS.D.OR.205 përmes IS.D.OR.260, nëse tregon në bindjen e këtij autoriteti se aktivitetet, objektet dhe burimet e saj, si dhe shërbimet që ajo operon, ofron, merr dhe mirëmban, nuk paraqesin ndonjë rrezik sigurie informacioni me një ndikim të mundshëm mbi sigurinë në operim as për veten e as për organizatat e tjera. Miratimi bazohet në një vlerësim të dokumentuar të rrezikut të sigurisë së informacionit të kryer nga organizata ose një palë e tretë në përputhje me pikën IS.D.OR.205 dhe të rishikuar dhe miratuar nga autoriteti i saj kompetent.

Vlefshmëria e vazhdueshme e atij miratimi rishikohet nga autoriteti kompetent pas ciklit të zbatueshëm të auditimit të mbikëqyrjes dhe sa herë që zbatohen ndryshime në fushën e punës së organizatës.

IS.D.OR.205 Vlerësimi i rrezikut të sigurisë së informacionit

a) Organizata duhet të identifikojë të gjitha elementet e saj, të cilat mund të ekspozohen ndaj rreziqeve të sigurisë së informacionit. Kjo përfshin:

1. aktivitetet, objektet dhe burimet e organizatës, si dhe shërbimet që organizata operon, ofron, merr ose mirëmban;

2. pajisjet, sistemet, të dhënat dhe informacionet që kontribuojnë në funksionimin e elementeve të renditura në pikën 1.

b) Organizata duhet të identifikojë ndërlidhjet që ajo ka me organizatat e tjera dhe të cilat mund të rezultojnë në ekspozimin e ndërsjellë ndaj rreziqeve të sigurisë së informacionit.

c) Në lidhje me elementet dhe ndërlidhjet e përmendura në shkronjat "a" dhe "b", organizata duhet të identifikojë rreziqet e sigurisë së informacionit, që mund të kenë një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim. Për çdo rrezik të identifikuar, organizata duhet:

1. të caktojë një nivel rreziku sipas një klasifikimi të paracaktuar të vendosur nga organizata;

2. të lidhë çdo rrezik dhe nivelin e tij me elementin ose ndërlidhjen përkatëse të identifikuar në përputhje me shkronjat "a" dhe "b".

Klasifikimi i paracaktuar i referuar në pikën 1 do të marrë parasysh potencialin e shfaqjes së skenarit të kërcënimit dhe ashpërsinë e pasojave të tij të sigurisë. Bazuar në atë klasifikim, dhe duke marrë parasysh nëse organizata ka një proces të strukturuar dhe të përsëritshëm të menaxhimit të rrezikut për operimet, organizata duhet të jetë në gjendje të përcaktojë nëse rreziku është i pranueshëm ose duhet të trajtohet në përputhje me pikën IS.D.OR.210.

Për të lehtësuar krahasueshmërinë e ndërsjellë të vlerësimeve të rreziqeve, caktimi i nivelit të rrezikut në përputhje me pikën 1 do të marrë parasysh informacionin përkatës të marrë në koordinim me organizatat e përmendura në shkronjën "b".

d) Organizata duhet të rishikojë dhe përditësojë vlerësimin e rrezikut të kryer në përputhje me shkronjat "a", "b" dhe "c" në cilëndo nga situatat e mëposhtme:

1. ka një ndryshim në elementet që u nënshtrohen rreziqeve të sigurisë së informacionit;

2. ka një ndryshim në lidhjet ndërmjet organizatës dhe organizatave të tjera, ose në rreziqet e komunikuara nga organizatat e tjera;

3. ka një ndryshim në informacionin ose njohuritë e përdorura për identifikimin, analizën dhe klasifikimin e rreziqeve;

4. ka mësime të nxjerra nga analiza e incidenteve të sigurisë së informacionit.

IS.D.OR.210 Trajtimi i rrezikut të sigurisë së informacionit

a) Organizata duhet të zhvillojë masa për të trajtuar rreziqet e papranueshme të identifikuara në përputhje me pikën IS.D.OR.205, t'i zbatojë ato në kohën e duhur dhe të kontrollojë efektivitetin e tyre të vazhdueshëm. Këto masa do t'i mundësojnë organizatës, që të:

1. Kontrollojë rrethanat që kontribuojnë në shfaqjen efektive të skenarit të kërcënimit;

2. Zvogëlojë pasojat në sigurinë e aviacionit që lidhen me materializimin e skenarit të kërcënimit;

3. Shmangë rreziqet.

Këto masa nuk do të sjellin ndonjë rrezik të ri të mundshëm të papranueshëm për sigurinë në operim.

b) Personi i përmendur në pikën IS.D.OR.240(a) dhe (b) dhe personeli tjetër i prekur i organizatës duhet të informohet për rezultatin e vlerësimit të rrezikut të kryer në përputhje me pikën IS.D.OR.205, skenarët përkatës të kërcënimit dhe masat që duhen zbatuar.

Organizata duhet, gjithashtu, të informojë organizatat me të cilat ka një ndërlidhje në përputhje

me pikën IS.D.OR.205(b) për çdo rrezik të ndarë midis të dyja organizatave.

IS.D.OR.215 Skema e raportimit të brendshëm të sigurisë së informacionit

a) Organizata krijon një skemë të brendshme raportimi për të mundësuar mbledhjen dhe vlerësimin e ngjarjeve të sigurisë së informacionit, duke përfshirë ato që do të raportohen në përputhje me pikën IS.D.OR.230.

b) Kjo skemë dhe procesi i përmendur në pikën IS.D.OR.220 i mundëson organizatës, që të:

1. identifikojë se cilat nga ngjarjet e raportuara në përputhje me shkronjën "a" konsiderohen si incidente ose cenueshmëri të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim;

2. identifikojë shkaqet dhe faktorët që kontribuojnë në incidentet dhe cenueshmëritë e sigurisë së informacionit të identifikuara në përputhje me pikën 1, dhe adresojë ato si pjesë e procesit të menaxhimit të rrezikut të sigurisë së informacionit në përputhje me pikat IS.D.OR.205 dhe IS.D.OR.220;

3. sigurojë një vlerësim të të gjithë informacionit të njohur, përkatës në lidhje me incidentet dhe cenueshmëritë e sigurisë së informacionit të identifikuara në përputhje me pikën 1;

4. sigurojë zbatimin e një metode për shpërndarjen e brendshme të informacionit sipas nevojës.

c) Çdo organizate të kontraktuar e cila mund ta ekspozojë organizatën ndaj rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë e aviacionit do t'i kërkohet të raportojë ngjarjet e sigurisë së informacionit tek organizata. Këto raporte do të dorëzohen duke përdorur procedurat e përcaktuara në marrëveshjet specifike kontraktuale dhe do të vlerësohen në përputhje me shkronjën "b".

d) Organizata bashkëpunon në hetime me çdo organizatë tjetër që ka një kontribut të rëndësishëm në sigurinë e informacionit të aktiviteteve të saj.

e) Organizata mund ta integrojë atë skemë raportimi me skema të tjera raportimi që ajo ka zbatuar tashmë.

IS.D.OR.220 Incidentet e sigurisë së informacionit – zbulimi, reagimi dhe rikuperimi

a) Bazuar në rezultatin e vlerësimit të rrezikut të kryer në përputhje me pikën IS.D.OR.205 dhe rezultatin e trajtimit të rrezikut të kryer në përputhje me pikën IS.D.OR.210, organizata do të zbatojë masat për zbulimin e incidenteve dhe dobësitë që tregojnë materializimin e mundshëm të rreziqeve të papranueshme dhe që mund të kenë një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim. Këto masa zbulimi do t'i mundësojnë organizatës, që të:

1. identifikojë devijimet nga linjat bazë të performancës funksionale të paracaktuara;

2. aktivizojë paralajmërimet për të aktivizuar masat e duhura të reagimit, në rast të ndonjë devijimi.

b) Organizata do të zbatojë masa për t'iu përgjigjur çdo kushti ngjarjeje të identifikuar në përputhje me shkronjën "a" që mund të zhvillohet ose të jetë shndërruar në një incident të sigurisë së informacionit. Këto masa reagimi do t'i mundësojnë organizatës, që të:

1. iniciojë reagimin ndaj paralajmërimeve të përmendura në pikën (a)(2), duke aktivizuar burimet dhe kursin e veprimeve të paracaktuara;

2. përmbajë përhapjen e një sulmi dhe të shmangë materializimin e plotë të një skenari kërcënimi;

3. kontrollojë mënyrën e dështimit të elementeve të prekura të përcaktuara në pikën IS.D.OR.205(a).

c) Organizata zbaton masa që synojnë rikuperimin nga incidentet e sigurisë së informacionit, duke përfshirë masat emergjente, nëse është e nevojshme. Këto masa rikuperimi do t'i mundësojnë organizatës, që të:

1. heqë gjendjen që shkaktoi incidentin, ose kufizojë atë në një nivel të tolerueshëm;

2. arrijë një gjendje të sigurt të elementeve të prekura të përcaktuara në pikën IS.D.OR.205(a), brenda një kohe rikuperimi të përcaktuar më parë nga organizata.

IS.D.OR.225 Përgjigje ndaj gjetjeve të njoftuara nga autoriteti kompetent

a) Pas marrjes së njoftimit për gjetjet e dorëzuara nga autoriteti kompetent, organizata duhet të:

1. identifikojë shkakun kryesor ose shkaqet dhe faktorët që kontribuojnë në mospërputhje;

2. përcaktojë një plan veprimi korrigjues;

3. demonstrojë korrigjimin e mospërputhshmërisë sipas dëshirës së autoritetit kompetent.

b) Veprimet e përmendura në shkronjën "a" kryhen brenda periudhës së rënë dakord me autoritetin kompetent.

IS.D.OR.230 Skema e raportimit të jashtëm të sigurisë së informacionit

a) Organizata zbaton një sistem raportimi për sigurinë e informacionit që përputhet me kërkesat e përcaktuara në urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, "Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë", dhe çdo ndryshim i tij nëse kjo Rregullore është e zbatueshme për organizatën.

b) Pa cenuar detyrimet e urdhrit të ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, "Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë", organizata duhet të sigurojë që çdo incident ose cenueshmëri e sigurisë së informacionit, që mund të përfaqësojë një rrezik të rëndësishëm për sigurinë e aviacionit, t'i raportohet autoritetit të tyre kompetent. Për më tepër:

1. kur një incident ose cenueshmëri e tillë prek një avion ose sistem ose përbërës të lidhur, organizata duhet t'ia raportojë, gjithashtu, mbajtësit të miratimit të projektimit;

2. kur një incident ose cenueshmëri e tillë prek një sistem ose përbërës të përdorur nga organizata, organizata duhet t'ia raportojë atë organizatës përgjegjëse për hartimin e sistemit ose përbërësit.

c) Organizata duhet të raportojë kushtet e përmendura në shkronjën "b", si më poshtë:

1. një njoftim do t'i dorëzohet autoritetit kompetent dhe, nëse është e aplikueshme, mbajtësit të miratimit të projektimit ose organizatës përgjegjëse për projektimin e sistemit ose përbërësit, sapo organizata të jetë e njohur për gjendjen;

2. një raport do t'i dorëzohet autoritetit kompetent dhe, nëse është e aplikueshme, mbajtësit të miratimit të projektimit ose organizatës përgjegjëse për projektimin e sistemit ose përbërësit, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më shumë se 72 orë nga koha kur organizata është vënë në dijeni për rrethanën, përveç rasteve kur rrethanat e jashtëzakonshme e pengojnë këtë.

Raporti do të bëhet në formën e përcaktuar nga autoriteti kompetent dhe do të përmbajë të gjithë informacionin përkatës për gjendjen e njohur për organizatën;

3. një raport vijues do t'i dorëzohet autoritetit kompetent dhe, nëse është e aplikueshme, mbajtësit të miratimit të projektimit ose organizatës përgjegjëse për projektimin e sistemit ose përbërësit, duke ofruar detaje të veprimeve që organizata ka ndërmarrë ose synon të ndërmarrë për t'u rimëkëmbur nga incidenti dhe veprimet që synon të ndërmarrë për të parandaluar incidente të ngjashme të sigurisë së informacionit në të ardhmen.

Raporti vijues do të dorëzohet sapo të jenë identifikuar këto veprime dhe do të përgatitet në formën e përcaktuar nga autoriteti kompetent.

IS.D.OR.235 Kontraktimi i aktiviteteve të menaxhimit të sigurisë së informacionit

a) Organizata duhet të sigurojë që kur kontrakton ndonjë pjesë të aktiviteteve të përmendura në pikën IS.D.OR.200 me organizata të tjera, aktivitetet e kontraktuara janë në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe organizata e kontraktuar punon nën mbikëqyrjen e saj. Organizata duhet të sigurojë që rreziqet që lidhen me aktivitetet e kontraktuara të menaxhohen siç duhet.

b) Organizata duhet të sigurojë që autoriteti kompetent mund të ketë akses me kërkesë të organizatës së kontraktuar për të përcaktuar pajtueshmërinë e vazhdueshme me kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në këtë Rregullore.

IS.D.OR.240 Kërkesat për personelin

a) Menaxheri përgjegjës i organizatës ose, në rastin e organizatave projektuese, drejtuesi i organizatës së projektimit, i caktuar në përputhje me urdhrin e ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, "Për miratimin e Rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për kërkesat e aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit" dhe urdhrit të ministrit nr. 170, datë 13.9.2022, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, i përmendur në shkronjat "a" dhe "b" të nenit 2 të kësaj Rregulloreje, do të ketë autoritetin e korporatës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e kërkuara nga kjo Rregullore mund të financohen dhe kryhen.

Ai person do të:

1. sigurojë që të gjitha burimet e nevojshme janë në dispozicion për të përmbushur kërkesat e kësaj Rregulloreje;

2. krijojë dhe promovojë politikën e sigurisë së informacionit të përmendur në pikën IS.D.OR.200(a)(1);

3. demonstrojë një kuptim të mirë të kësaj Rregulloreje.

b) Menaxheri përgjegjës ose, në rastin e organizatave projektuese, drejtuesi i organizatës së projektimit, cakton një person ose grup personash për të siguruar që organizata është në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe përcakton shtrirjen e autoritetit të tyre. Ai person ose grup personash duhet t'i raportojë drejtpërdrejt menaxherit përgjegjës ose, në rastin e organizatave të projektimit, kreut të organizatës projektuese dhe duhet të ketë njohuritë, përgatitjen dhe përvojën e duhur për të përmbushur përgjegjësitë përkatëse. Në procedurë do të përcaktohet se kush e zëvendëson një person të caktuar në rast të mungesës së gjatë të atij personi.

c) Menaxheri përgjegjës ose, në rastin e organizatave projektuese, drejtuesi i organizatës së projektimit do të emërojë një person ose grup personash me përgjegjësi për të menaxhuar funksionin e monitorimit të pajtueshmërisë të përmendur në pikën IS.D.OR.200(a)(12).

d) Kur organizata ndan strukturat organizative, politikat, proceset dhe procedurat e sigurisë së informacionit, me organizata të tjera ose me zona të organizatës së tyre që nuk janë pjesë e miratimit ose deklaratës, menaxheri përgjegjës ose, në rastin e organizatave projektuese, drejtuesi i organizatës projektuese, mund t'ia delegojë aktivitetet e saj një personi të përbashkët përgjegjës.

Në një rast të tillë, masat e koordinimit do të vendosen ndërmjet menaxherit përgjegjës të organizatës ose, në rastin e organizatave projektuese, kreut të organizatës projektuese dhe personit të përbashkët përgjegjës për të siguruar integrimin e duhur të menaxhimit të sigurisë së informacionit brenda organizatës.

e) Menaxheri përgjegjës ose drejtuesi i organizatës së projektimit, ose personi përgjegjës i përbashkët i përmendur në shkronjën "d", ka autoritetin e korporatës për të krijuar dhe mirëmbajtur strukturat organizative, politikat, proceset dhe procedurat e nevojshme për zbatimin e pikës IS.D.OR.200.

f) Organizata duhet të ketë një proces të vendosur për të siguruar që ka personel të mjaftueshëm në detyrë për të kryer aktivitetet e mbuluara nga ky aneks.

g) Organizata duhet të ketë një proces të vendosur për të siguruar që personeli i përmendur në shkronjën "f" të ketë kompetencën e nevojshme për të kryer detyrat e tyre.

h) Organizata duhet të ketë një proces të vendosur për të siguruar që personeli të pranojë përgjegjësitë që lidhen me rolet dhe detyrat e caktuara.

i) Organizata duhet të sigurojë që identiteti dhe besueshmëria e personelit që ka akses në sistemet e informacionit dhe të dhënat që u nënshtrohen kërkesave të kësaj Rregulloreje janë përcaktuar siç duhet.

IS.D.OR.245 Ruajtja e të dhënave

a) Organizata duhet të regjistrojë të dhënat për aktivitetet e saj të menaxhimit të sigurisë së informacionit

1. Organizata duhet të sigurojë që të dhënat e mëposhtme janë të arkivuara dhe të gjurmueshme:

i. çdo miratim i marrë dhe çdo vlerësim shoqërues i rrezikut të sigurisë së informacionit në përputhje me pikën IS.D.OR.200(e);

ii. kontratat për aktivitetet e përmendura në pikën IS.D.OR.200(a)(9);

iii. regjistrimet e proceseve kryesore të përmendura në pikën IS.D.OR.200(d);

iv. të dhënat e rreziqeve të identifikuara në vlerësimin e rrezikut të përmendur në pikën IS.D.OR.205 së bashku me masat shoqëruese të trajtimit të rrezikut të përmendura në pikën IS.D.OR.210;

v. të dhënat e incidenteve dhe cenueshmërive të sigurisë së informacionit të raportuara në përputhje me skemat e raportimit të përmendura në pikat IS.D.OR.215 dhe IS.D.OR.230;

vi. të dhënat e atyre ngjarjeve të sigurisë së informacionit që mund të kenë nevojë të rivlerësohen për të zbuluar incidente ose cenueshmëri të pazbuluara të sigurisë së informacionit.

2. Regjistrimet e përmendura në pikën (1)(i) mbahen të paktën deri në 5 vjet pasi miratimi të ketë humbur vlefshmërinë e tij.

3. Të dhënat e përmendura në pikën (1)(ii) mbahen të paktën deri në 5 vjet pas ndryshimit ose përfundimit të kontratës.

4. Të dhënat e përmendura në pikën (1)(iii), (iv) dhe (v) mbahen të paktën për një periudhë prej 5 vjetësh.

5. Regjistrimet e përmendura në pikën (1)(vi) mbahen derisa ato ngjarje të sigurisë së informacionit të rivlerësohen në përputhje me një

periodicitet të përcaktuar në një procedurë të vendosur nga organizata.

b) Organizata duhet të mbajë shënime për kualifikimin dhe përvojën e stafit të vet të përfshirë në aktivitetet e menaxhimit të sigurisë së informacionit

1. të dhënat e kualifikimit dhe përvojës së personelit ruhen për aq kohë sa personi punon për organizatën dhe për të paktën 3 vjet pasi personi të jetë larguar nga organizata;

2. anëtarëve të personelit, me kërkesën e tyre, u jepet akses në të dhënat e tyre individuale; përveç kësaj, me kërkesën e tyre, organizata do t'u sigurojë atyre një kopje të të dhënave të tyre individuale pas largimit nga organizata.

c) Formati i të dhënave specifikohet në procedurat e organizatës.

d) Regjistrimet ruhen në një mënyrë që siguron mbrojtje nga dëmtimi, ndryshimi dhe vjedhja, me informacionin që identifikohet, kur kërkohet, sipas nivelit të klasifikimit të sigurisë. Organizata duhet të sigurojë që të dhënat të ruhen duke përdorur mjete për të siguruar integritetin, autenticitetin dhe aksesin e autorizuar.

IS.D.OR.250 Manuali i menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMM)

a) Organizata duhet t'i vërë në dispozicion autoritetit kompetent një manual për menaxhimin e sigurisë së informacionit (ISMM) dhe, kur është e aplikueshme, çdo manual dhe procedurë të lidhur me referencë, që përmban:

1. një deklaratë të nënshkruar nga menaxheri përgjegjës ose, në rastin e organizatave projektuese, nga drejtuesi i organizatës së projektimit, që konfirmon se organizata do të punojë në çdo kohë në përputhje me këtë aneks dhe me ISMM-në; nëse menaxheri përgjegjës ose, në rastin e organizatave të projektimit, drejtuesi i organizatës së projektimit, nuk është shefi ekzekutiv (CEO) i organizatës, atëherë CEO i tillë duhet të kundërfirmojë deklaratën;

2. titujt, emrat, detyrat, përgjegjësitë, përgjegjësitë dhe autoritetet e personit ose personave të përmendur në pikën IS.D.OR.240(b) dhe (c);

3. titullin, emrin, detyrat, përgjegjësitë dhe autoritetet e personit përgjegjës të përbashkët të përmendur në pikën IS.D.OR.240(d), nëse është e aplikueshme;

4. politikën e sigurisë së informacionit të organizatës, siç referohet në pikën IS.D.OR.200(a)(1);

5. një përshkrim të përgjithshëm të numrit dhe kategorive të personelit dhe të sistemit të vendosur për të planifikuar disponueshmërinë e personelit, siç kërkohet nga pika IS.D.OR.240;

6. titujt, emrat, detyrat, përgjegjësitë dhe autoritetet e personave kyç përgjegjës për zbatimin e pikës IS.D.OR.200, duke përfshirë personin ose personat përgjegjës për funksionin e monitorimit të pajtueshmërisë të përmendur në pika IS.D.OR.200(a)(12);

7. një organigramë që tregon zinxhirët shoqërues të llogaridhënies dhe përgjegjësisë për personat e përmendur në pikat 2 dhe 6;

8. përshkrimin e skemës së raportimit të brendshëm të përmendur në pikën IS.D.OR.215;

9. procedurat që përcaktojnë se si organizata siguron përputhjen me këtë pjesë, dhe në veçanti:

i. pika e dokumentacionit IS.D.OR.200(c);

ii. procedurat që përcaktojnë se si organizata kontrollon çdo aktivitet të kontraktuar të përmendur në pikën IS.D.OR.200(a)(9);

iii. procedurën e ndryshimit të ISMM të përcaktuar në shkronjën "c";

10. detajet e mjeteve alternative të pajtueshmërisë të miratuara aktualisht.

b) Lëshimi fillestar i ISMM-së miratohet dhe një kopje mbahet nga autoriteti kompetent. Nuk kërkohet miratim për deklarimin e organizatave. ISMM ndryshohet sipas nevojës, me qëllim që të mbetet një përshkrim i përditësuar i ISMM-së së organizatës. Një kopje e çdo ndryshimi në ISMM duhet t'i jepet autoritetit kompetent.

c) Ndryshimet në ISMM menaxhohen sipas procedurës së përcaktuar nga organizata. Çdo ndryshim që nuk përfshihet në objektin e kësaj procedure dhe çdo ndryshim në lidhje me ndryshimet e përmendura në pikën IS.D.OR.255(b), miratohet nga autoriteti kompetent. Nuk kërkohet miratim për deklarimin e organizatave.

d) Organizata mund të integrojë ISMM-në me dokumente ose manuale të tjera menaxheriale që mban, me kusht që të ketë një referencë të qartë të kryqëzuar që tregon se cilat pjesë të dokumentit ose manualit të menaxhimit korrespondojnë me kërkesat e ndryshme të përfshira në këtë aneks.

IS.D.OR.255 Ndryshime në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit

a) Ndryshimet në ISMS mund të menaxhohen dhe t'i njoftohen autoritetit kompetent në një procedurë të zhvilluar nga organizata. Kjo procedurë miratohet nga autoriteti kompetent, me përjashtim të organizatave deklaruese.

b) Në lidhje me ndryshimet në ISMS që nuk mbulohen nga procedura e përmendur në shkronjën "a", organizata duhet të aplikojë dhe të marrë një miratim të lëshuar nga autoriteti kompetent, me përjashtim të organizatave deklaruese, për të cilat nuk kërkohet miratim.

Në lidhje me këto ndryshime:

1. aplikimi duhet të dorëzohet përpara se të ndodhë një ndryshim i tillë, në mënyrë që t'i mundësojë autoritetit kompetent të përcaktojë pajtueshmërinë e vazhdueshme me këtë Rregullore dhe të ndryshojë, nëse është e nevojshme, certifikatën e organizatës dhe kushtet përkatëse të miratimit që i bashkëlidhen;

2. organizata vë në dispozicion të autoritetit kompetent çdo informacion që kërkon për të vlerësuar ndryshimin;

3. ndryshimi zbatohet vetëm pas marrjes së një miratimi zyrtar nga autoriteti kompetent, me përjashtim të organizatave deklaruese, të cilat mund ta zbatojnë menjëherë ndryshimin;

4. organizata operon sipas kushteve të përcaktuara nga autoriteti kompetent gjatë zbatimit të këtyre ndryshimeve.

IS.D.OR.260 Përmirësimi i vazhdueshëm

a) Organizata vlerëson, duke përdorur tregues të përshtatshëm të performancës, efektivitetin dhe pjekurinë e ISMS-së. Ky vlerësim kryhet mbi një bazë kalendarike të paracaktuar nga organizata ose pas një incidenti të sigurisë së informacionit.

b) Nëse konstatohen mangësi pas vlerësimit të kryer në përputhje me shkronjën "a", organizata merr masat e nevojshme të përmirësimit për të siguruar që ISMS-ja të vazhdojë të jetë në përputhje me kërkesat e zbatueshme dhe të mbajë rreziqet e sigurisë së informacionit në një nivel të pranueshëm. Përveç kësaj, organizata rivlerëson ato elemente të ISMS-së, që preken nga masat e miratuara.

SHTOJCA II
RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 1095, DATË 24.12.2020, "PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE THELBËSORE NË FUSHËN E AVIACIONIT CIVIL", të NDRYSHUAR, NË LIDHJE ME KËRKESAT PËR MENAXHIMIN E RREZIQEVE TË SIGURISË SË INFORMACIONIT ME NJË NDIKIM TË MUNDSHËM NË SIGURINË NË OPERIM PËR ORGANIZATAT E MBULUARA NGA URDHRAT E MINISTRIT: NR. 79, DATË 15.4.2024, NR. 80, DATË 30.6.2023, I NDRYSHUAR, NR. 178, DATË 20.12.2023, I NDRYSHUAR, NR. 171, DATË 11.11.2025, NR. 193, DATË 6.10.2022, I NDRYSHUAR, NR. 119, DATË 29.9.2023, DHE PËR AUTORITETET KOMPETENTE TË MBULUARA NGA URDHRAT E MINISTRIT: NR. 57, DATË 13.3.2024, NR. 79, DATË 15.4.2024, NR. 80, DATË 30.6.2023, I NDRYSHUAR, NR. 178, DATË 20.12.2023, I NDRYSHUAR, NR. 171, DATË 11.11.2025, NR. 170, DATË 13.9.2022, I NDRYSHUAR, NR. 193, DATË 6.10.2022, I NDRYSHUAR, NR. 119, DATË 29.9.2023

Neni 1
Objekti

Kjo Rregullore përcakton kërkesat që duhet të plotësojnë organizatat dhe autoritetet kompetente në mënyrë që:

a) të identifikojnë dhe menaxhojnë rreziqet e sigurisë së informacionit me ndikim të mundshëm në sigurinë në operim, të cilat mund të ndikojnë në sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe të dhënat e përdorura për qëllime të aviacionit civil;

b) të zbulojnë ngjarjet e sigurisë së informacionit dhe të identifikojnë ato që konsiderohen si incidente të sigurisë së informacionit me ndikim të mundshëm në sigurinë në operim,

c) t'i përgjigjen dhe të rikuperojnë këto incidente të sigurisë së informacionit.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet për organizatat e mëposhtme:

a) organizatat e mirëmbajtjes që i nënshtrohen seksionit A të aneksit II (pjesa-145) të urdhrit të ministrit nr. 79, datë 15.4.2024, "Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra", përveç atyre të përfshira vetëm në mirëmbajtjen e avionëve në përputhje me aneksin Vb (pjesa-ML) të urdhrit të ministrit nr. 79, datë 15.4.2024, "Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra";

b) organizatat e menaxhimit të vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore (CAMO) që i nënshtrohen seksionit A të aneksit Vc (pjesa-CAMO) të urdhrit të ministrit nr. 79, datë 15.4.2024, "Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra", përveç atyre të përfshira vetëm në menaxhimin e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore të avionëve në përputhje me aneksin Vb (pjesa-ML) të urdhrit të ministrit nr. 79, datë 15.4.2024, "Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra";

c) operatorët ajrorë që i nënshtrohen aneksit III (pjesa-ORO) të urdhrit të ministrit nr. 80, datë 30.6.2023, "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore", të ndryshuar, me përjashtim të atyre që janë të përfshirë vetëm në përdorimin e ndonjërës nga sa vijon:

i. një avion ELA 2 siç përcaktohet në nenin 1(2), shkronja "j" të urdhrit të ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për kërkesa të aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit";

ii. aeroplanë me një helikë me një motor me një Konfigurim Maksimal Operimi të ulëseve të pasagjerëve prej 5 ose më pak, të cilët nuk klasifikohen si avionë me motor kompleks, kur ngrihen dhe ulen në të njëjtin aerodrom, ose vend operimi dhe operojnë sipas Rregullave të Fluturimit Vizual (VFR) sipas rregullave të ditës;

iii. helikopterë me një motor me një konfigurim maksimal operimi të ulëseve të pasagjerëve prej 5 ose më pak që nuk klasifikohen si avionë kompleksë me motor, kur ngrihen dhe ulen në të njëjtin aerodrom ose vend operimi dhe operojnë nën VFR sipas rregullave të ditës.

d) Organizatat e miratuara të trajnimit (ATO) që i nënshtrohen aneksit VII (pjesa-ORA) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil", të ndryshuar, përveç atyre të përfshira vetëm në aktivitetet e trajnimit të avionëve ELA2, siç përcaktohet në nenin 1, pika 2, shkronja "j" të urdhrit të ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për kërkesa të aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit", ose të përfshira vetëm në trajnimin teorik;

e) qendrat aeromjekësore të ekuipazheve ajrore që i nënshtrohen aneksit VII (pjesa-ORA) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil", të ndryshuar;

f) operatorët e pajisjeve të trajnimit të simulimit të fluturimit (FSTD) që i nënshtrohen aneksit VII (pjesa-ORA) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil", të ndryshuar, përveç atyre të përfshira vetëm në operimin e FSTD-ve për avionët ELA2, siç përcaktohet në nenin 1 (2), shkronja "j", të urdhrit të ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, "Për miratimin

e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për kërkesa të aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit";

g) organizatat e trajnimit të kontrollorëve të trafikut ajror (ATCO TO) dhe qendrat aeromjekësore ATCO që i nënshtrohen aneksit III (pjesa KTA.OR) të urdhrit të ministrit nr. 171, datë 11.11.2025, "Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e kërkesave teknike edhe procedurave administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror";

h) organizatat që i nënshtrohen aneksit III (pjesa-ATM/ANS.OR) të urdhrit të ministrit nr. 193, datë 6.10.2022, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre", të ndryshuar, me përjashtim të ofruesve të shërbimeve në vijim:

i. ofruesit e shërbimeve të lundrimit ajror që mbajnë një certifikatë të kufizuar në përputhje me pikën ATM/ANS.OR.A.010 të atij aneksi;

ii. ofruesit e shërbimit të informacionit të fluturimit që deklarojnë aktivitetet e tyre në përputhje me pikën ATM/ANS.OR.A.015 të atij aneksi;

i) ofruesit e shërbimeve të hapësirës – U dhe ofruesit e vetëm të përbashkët të shërbimeve të informacionit që i nënshtrohen urdhrit të ministrit nr. 119, datë 29.9.2023, "Për miratimin e rregullores mbi kuadrin rregullator për hapësirën – U të hapësirës ajrore".

j) organizatat e miratuara të përfshira në projektimin ose prodhimin e sistemeve ATM/ANS dhe përbërësve ATM/ANS që i nënshtrohen shtojcës II mbi rregulloren që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin, ose prodhimin e sistemeve dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të lundrimit ajror, që përafron rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2023/1769, të urdhrit të ministrit nr. 40, datë 12.3.2025.

2. Kjo rregullore zbatohet për Autoritetin e Aviacionit Civil, kur ai është përcaktuar si autoritet kompetente, referuar nenit 6 të kësaj Rregulloreje dhe nenit 5 të Rregullores për përcaktimin e rregullave për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", të ndryshuar, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat e mbuluara nga urdhrit të ministrit nr. 57, datë 13.3.2024 dhe urdhrit të ministrit nr. 170, datë 13.9.2022, i ndryshuar, që përafron Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1645, sipas shtojcës I të këtij urdhri apo urdhrave të ministrit ku referon ky nen.

3. Kjo Rregullore zbatohet, gjithashtu, për Autoritetin e Aviacionit Civil kur ai është përcaktuar si autoriteti kompetent përgjegjës për lëshimin, vazhdimin, ndryshimin, pezullimin ose heqjen e licencave të mirëmbajtjes së avionëve në përputhje me aneksin III (pjesa-66) të urdhrit të ministrit nr. 79, datë 15.4.2024, "Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra".

3a. Kjo Rregullore zbatohet, gjithashtu, për Autoritetin e Aviacionit Civil kur ai është përcaktuar si autoriteti kompetent përgjegjës për mbikëqyrjen e vazhdueshmërisë së vlefshmërisë ajrore të sistemeve të avionëve pa pilot individuale (UA) dhe për lëshimin e certifikatave të tyre të rishikimit të vlefshmërisë ajrore sipas Rregullores për përcaktimin e kërkesave për autoritetin kompetent dhe procedurave administrative për certifikimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e vlefshmërisë së vazhdueshme të sistemeve të avionëve pa pilot të certifikuar, që përafron Rregulloren Evropiane 2024/1109, si dhe për mbikëqyrjen e një organizate, siç përcaktohet në Rregulloren që përcakton rregullat e detajuara për vazhdimin e vlefshmërisë se sistemeve të avionëve pa pilot të certifikuar dhe të përbërësve të tyre, si dhe për miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra që përafron Rregulloren Evropiane 2024/1107.

4. Kjo Rregullore nuk cenon kërkesat e sigurisë së informacionit dhe sigurisë kibernetike të përcaktuara në VKM nr. 411, datë 19.6.2024, "Për

miratimin e Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil", dhe në legjislacioni në fuqi për sigurinë kibernetike.

Neni 3
Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. "Siguria e informacionit" nënkupton ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit, autenticitetit dhe disponueshmërisë së rrjetit dhe sistemeve të informacionit;

2. "Ngjarje e sigurisë së informacionit" nënkupton një ndodhi të identifikuar të një sistemi, shërbimi ose gjendjeje rrjeti që tregon një shkelje të mundshme të politikës së sigurisë së informacionit ose dështimin e kontrolleve të sigurisë së informacionit, ose një situatë të panjohur më parë që mund të jetë e rëndësishme për sigurinë e informacionit;

3. "Incident" është çdo ngjarje që komprometon disponueshmërinë, vërtetësinë, integritetin, konfidencialitetin e të dhënave të ruajtura, të transmetuara apo të përpunuara ose të shërbimeve të ofruara apo të aksesueshme përmes rrjeteve dhe sistemeve të informacionit;

4. "Rreziku i sigurisë së informacionit" nënkupton rrezikun për operimet organizative të aviacionit civil, asetet, individët dhe organizatat e tjera, për shkak të potencialit të një ngjarjeje të sigurisë së informacionit. Rreziqet e sigurisë së informacionit shoqërohen me potencialin që kërcënimet të shfrytëzojnë dobësitë e një aseti informacioni ose një grupi asetesh informacioni;

5. "Kërcënim" nënkupton një shkelje të mundshme të sigurisë së informacionit që ekziston, kur ekziston një subjekt, rrethanë, veprim ose ngjarje që mund të shkaktojë dëm;

6. "Vulnerabilitet" nënkupton një defekt ose cenueshmëri në një aset ose një sistem, procedurë, projektim, zbatim, ose masa sigurie informacioni që mund të shfrytëzohen dhe që rezulton në një tejkalim, ose shkelje të politikës së sigurisë së informacionit.

Neni 4
Kërkesat për organizatat dhe autoritetet kompetente

1. Organizatat e përmendura në nenin 2, pika 1, duhet të jenë në përputhje me kërkesat e aneksit II (pjesa-IS.I.OR) të kësaj Rregulloreje.

2. Autoritetet kompetente të përmendura në nenin 2, pika 2, 3 dhe 3(a) duhet të jenë në përputhje me kërkesat e aneksit I (pjesa-IS.AR) të kësaj Rregulloreje.

Neni 5
Kërkesat që lindin nga legjislacioni tjetër kombëtar

1. Kur një organizatë e përmendur në nenin 2, pika 1, zbaton kërkesat e sigurisë të përcaktuara në përputhje me legjislacioni në fuqi për sigurinë kibernetike, që janë të barasvlershme me kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore, zbatimi i atyre kërkesave të sigurisë duhet të konsiderohet se përbën zbatim të kërkesave të përcaktuara në këtë Rregullore.

2. Kur një organizatë e përmendur në nenin 2, pika 1, është një operator ose një subjekt i referuar në programet kombëtare të sigurisë në operim të përcaktuara në përputhje me nenin 10 të udhëzimit nr. 26, datë 20.10.2010, "Mbi rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së Aviacionit Civil", kërkesat për sigurinë kibernetike të përfshira në VKM-në nr. 411, datë 19.6.2024, "Për miratimin e Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil", si dhe në aneksin e urdhrit të ministrit nr. 163, datë 26.3.2021, "Për përcaktimin e masave të detajuara për zbatimin e standardeve themelore të përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil", i ndryshuar, konsiderohen të barasvlershme me kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore, me përjashtim të pikës IS.I.OR.230 të aneksit II të kësaj Rregulloreje që do të respektohet si e tillë.

3. Ministri pas konsultimit me Autoritetin e Aviacionit Civil dhe Autoritetin përgjegjës për Sigurinë Kibernetike, mund të miratojë udhëzime për vlerësimin e ekuivalencës së kërkesave të përcaktuara në këtë Rregullore dhe rregullat kombëtare, në lidhje me masat për një nivel të lartë të sigurisë kibernetike.

Neni 6
Autoriteti kompetent

1. Autoriteti përgjegjës për certifikimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj Rregulloreje është:

a) në lidhje me organizatat e përmendura në nenin 2, pika 1, shkronja "a", Autoriteti i Aviacionit Civil kur ai është përcaktuar si autoriteti kompetent në përputhje me aneksin II (pjesa-145) të urdhrit të ministrit nr. 79, datë 15.4.2024, "Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra";

b) në lidhje me organizatat e përmendura në nenin 2, pika 1, shkronja "b", Autoriteti i Aviacionit Civil kur ai është përcaktuar si autoriteti kompetent në përputhje me aneksin Vc (pjesa-CAMO) të urdhrit të ministrit nr. 79, datë 15.4.2024, "Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra";

c) në lidhjet me organizatat e përmendura në nenin 2, pika 1, shkronja "c", Autoriteti i Aviacionit Civil kur ai është përcaktuar si autoriteti kompetent në përputhje me aneksin III (pjesa-ORO) të urdhrit të ministrit nr. 80, datë 30.6.2023, "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore", i ndryshuar;

d) në lidhje me organizatat e përmendura në nenin 2, pika 1, shkronjat "d" deri "f", shkronja "c", Autoriteti i Aviacionit Civil, kur ai është përcaktuar si autoriteti kompetent në përputhje me aneksin VII (pjesa-ORA) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative, në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil", i ndryshuar;

e) në lidhje me organizatat e përmendura në nenin 2, pika 1, shkronja "g", Autoriteti i Aviacionit Civil kur ai është përcaktuar si autoriteti kompetent në përputhje me nenin 6, pika 2, të urdhrit të ministrit nr. 171, datë 11.11.2025, "Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e kërkesave teknike edhe procedurave administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror";

f) në lidhje me organizatat e përmendura në nenin 2, pika 1, shkronja "h", Autoriteti i Aviacionit Civil kur ai është përcaktuar si autoriteti kompetent në përputhje me nenin 4, pika 1, të urdhrit të ministrit nr. 193, datë 6.10.2022, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre", i ndryshuar;

g) në lidhje me organizatat e përmendura në nenin 2, pika 1, shkronja "i", Autoriteti i Aviacionit Civil, kur ai është përcaktuar si autoriteti kompetent në përputhje me nenin 14, pika 1 ose pika 2, sipas rastit, të urdhrit të ministrit nr. 119, datë 29.9.2023, "Për miratimin e rregullores mbi kuadrin rregullator për hapësirën – U të hapësirës ajrore";

h) në lidhje me organizatat e përmendura në nenin 2, pika 1, shkronja "j", autoriteti kompetent i caktuar në përputhje me nenin 3, pika 1 të shtojcës II mbi rregulloren që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative për miratimin e organizatave të përfshira në projektimin ose prodhimin e sistemeve dhe përbërësve të menaxhimit të trafikut ajror/ shërbimeve të lundrimit ajror, të urdhrit të ministrit nr. 40, datë 12.3.2025, që përafron rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2023/1769.

2. Në rast se legjislacioni kombëtar, për qëllimet e kësaj Rregulloreje, përcakton një entitet të pavarur dhe autonom për të përmbushur rolin dhe përgjegjësitë e caktuara të autoriteteve kompetente të përmendura në pikën 1, masat e koordinimit do të vendosen ndërmjet atij entiteti dhe autoriteteve kompetente, e përmendura në pikën 1, për të siguruar mbikëqyrje efektive të të gjitha kërkesave që duhet të përmbushen nga organizatat.

Neni 7
Dorëzimi i informacionit përkatës pranë Autoritetit përgjegjës për sigurinë kibernetike

Autoritetet kompetente sipas kësaj Rregulloreje do të informojnë, pa vonesa të panevojshme, pikën e vetme të kontaktit të caktuar në përputhje me legjislacioni në fuqi për sigurinë kibernetike për çdo informacion përkatës të përfshirë në njoftimet e paraqitura në përputhje me pikën IS.I.OR.230 të aneksit II të kësaj Rregulloreje dhe pikës IS.D.OR.230 të aneksit I të Rregullores për përcaktimin e rregullave për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat e mbuluara nga urdhrit të ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, dhe urdhrit të ministrit nr. 170, datë 13.9.2022, i ndryshuar, që përafron rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) 2022/1645, sipas shtojcës I të këtij urdhri, nga operatorët e infrastrukturave të informacionit të identifikuar në përputhje me legjislacioni në fuqi për sigurinë kibernetike.

ANEKSI I
SIGURIA E INFORMACIONIT – KËRKESAT E AUTORITETIT

[PJESA-IS.AR]

IS.AR.100	Fushëveprimi
IS.AR.200	Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS)
IS.AR.205	Vlerësimi i rrezikut të sigurisë së informacionit
IS.AR.210	Trajtimi i rrezikut të sigurisë së informacionit
IS.AR.215	Incidentet e sigurisë së informacionit – zbulimi, reagimi dhe rikuperimi
IS.AR.220	Kontraktimi i aktiviteteve të menaxhimit të sigurisë së informacionit
IS.AR.225	Kërkesat e personelit
IS.AR.230	Ruajtja e të dhënave
IS.AR.235	Përmirësimi i vazhdueshëm

IS.AR.100 Fushëveprimi

Kjo pjesë përcakton kërkesat për menaxhimin që duhet të plotësojnë autoritetet kompetente të referuara në nenin 2, pika 2 të kësaj Rregulloreje.

Kërkesat që duhet të plotësojnë këto autoritete kompetente për kryerjen e aktiviteteve të tyre të certifikimit, mbikëqyrjes dhe zbatimit përmbahen në rregulloret e përmendura në nenin 2, pika 1, të kësaj Rregulloreje dhe në nenin 2 të Rregullores për përcaktimin e rregullave për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat e mbuluara nga urdhrit të ministrit nr. 57, datë 13.3.2024, dhe urdhrit të ministrit nr. 170, datë 13.9.2022, i ndryshuar, që përafron rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) 2022/1645, sipas shtojcës I të këtij urdhri.

IS.AR.200 Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS)

a) Për të arritur objektivat e përcaktuar në nenin 1, autoriteti kompetent ngre, zbaton dhe mirëmban një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS), i cili siguron që autoriteti kompetent:

1. vendos një politikë për sigurinë e informacionit që përcakton parimet e përgjithshme të autoritetit kompetent në lidhje me ndikimin e mundshëm të rreziqeve të sigurisë së informacionit në sigurinë në operim;

2. identifikon dhe rishikon rreziqet e sigurisë së informacionit në përputhje me pikën IS.AR.205;

3. përcakton dhe zbaton masat e trajtimit të rrezikut të sigurisë së informacionit në përputhje me pikën IS.AR.210;

4. përcakton dhe zbaton, në përputhje me pikën IS.AR.215, masat e kërkuara për zbulimin e ngjarjeve të sigurisë së informacionit, identifikon ato që konsiderohen si incidente me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim të aviacionit, dhe u përgjigjet dhe merret me rikuperimin pas këtyre incidenteve të sigurisë së informacionit;

5. përputhet me kërkesat e përfshira në pikën IS.AR.220, kur kontrakton ndonjë pjesë të aktiviteteve të përshkruara në pikën IS.AR.200 me organizata të tjera;

6. përputhet me kërkesat e personelit të përfshira në pikën IS.AR.225;

7. përputhet me kërkesat e mbajtjes së të dhënave të përfshira në pikën IS.AR.230;

8. monitoron përputhshmërinë e vetë organizatës së tij me kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe jep komente mbi gjetjet për personin e përmendur në pikën IS.AR.225 (a) për të siguruar zbatimin efektiv të veprimeve korrigjuese;

9. mbron konfidencialitetin e çdo informacioni që autoriteti kompetent mund të ketë në lidhje me organizatat që i nënshtrohen mbikëqyrjes së tij dhe informacionin e marrë nëpërmjet skemave të raportimit të jashtëm të organizatës, të përcaktuara në përputhje me pikën IS.I.OR.230 të aneksit II (pjesa-IS.I.OR) të kësaj Rregulloreje dhe pikës IS.D.OR.230 të aneksit (pjesa-IS.D.OR) të Rregullores për përcaktimin e rregullave për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", të ndryshuar, në lidhje me kërkesat për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim për organizatat e mbuluara nga urdhrit të ministrit nr. 57, datë 13.3.2024 dhe urdhrit të ministrit nr. 170, datë 13.9.2022, i ndryshuar, që përafron Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2022/1645, sipas shtojcës I të këtij urdhri.

10. kur të jetë e zbatueshme, njofton Agjencinë për ndryshimet që ndikojnë në aftësinë e autoritetit kompetent për të kryer detyrat e tij dhe për të mbuluar përgjegjësitë e tij siç janë përcaktuar në këtë Rregullore;

11. përcakton dhe zbaton procedurat për të ndarë sipas rastit dhe në mënyrë praktike dhe të përpiktë informacionin përkatës për të ndihmuar autoritetet kompetente dhe agjencitë e tjera, si dhe organizatat që i nënshtrohen kësaj Rregulloreje për të kryer vlerësime efektive të rrezikut të sigurisë në lidhje me aktivitetet e tyre.

b) Për të përmbushur vazhdimisht kërkesat e përmendura në nenin 1, autoriteti kompetent zbaton një proces përmirësimi të vazhdueshëm në përputhje me pikën IS.AR.235.

c) Autoriteti kompetent dokumenton të gjitha proceset, procedurat, rolet dhe përgjegjësitë kyçe që kërkohen për të qenë në përputhje me pikën IS.AR.200(a) dhe vendos një proces për ndryshimin e këtij dokumentacioni.

d) Proceset, procedurat, rolet dhe përgjegjësitë e përcaktuara nga autoriteti kompetent në zbatim të pikës IS.AR.200(a) përputhen me natyrën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të tij, bazuar në një vlerësim të rreziqeve të sigurisë së informacionit të qenësishme për ato aktivitete, dhe mund të integrohen brenda sistemeve të tjera ekzistuese të menaxhimit të zbatuara tashmë nga autoriteti kompetent.

IS.AR.205 Vlerësimi i rrezikut të sigurisë së informacionit

a) Autoriteti kompetent identifikon të gjitha elementet e organizatës së tij që mund të ekspozohen ndaj rreziqeve të sigurisë së informacionit. Kjo përfshin:

1. aktivitetet, objektet dhe burimet e autoritetit kompetent, si dhe shërbimet që autoriteti kompetent operon, ofron, merr ose mirëmban;

2. pajisjet, sistemet, të dhënat dhe informacionet që ndikojnë në funksionimin e elementeve të përmendura në pikën 1.

b) Autoriteti kompetent identifikon ndërlidhjet që organizata e tij ka me organizata të tjera dhe që mund të rezultojë në ekspozimin e ndërsjellë ndaj rreziqeve të sigurisë së informacionit.

c) Për elementet dhe ndërlidhjet e përmendura në shkronjat "a" dhe "b", autoriteti kompetent identifikon rreziqet e sigurisë së informacionit që mund të kenë një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim.

Për çdo rrezik të identifikuar, autoriteti kompetent duhet:

1. të caktojë një nivel rreziku sipas një klasifikimi të paracaktuar të vendosur nga autoriteti kompetent;

2. të lidhë çdo rrezik dhe nivelin e tij me elementin ose ndërlidhjen përkatëse të identifikuar në përputhje me shkronjat "a" dhe "b".

Klasifikimi i paracaktuar i referuar në pikën 1 merr parasysh potencialin e shfaqjes së skenarit kërcënues dhe ashpërsinë e pasojave të tij mbi sigurinë në operim. Nëpërmjet këtij klasifikimi dhe duke marrë parasysh nëse autoriteti kompetent ka një proces të strukturuar dhe të përsëritshëm të menaxhimit të rrezikut për operimet, autoriteti kompetent do të jetë në gjendje të përcaktojë nëse rreziku është i pranueshëm ose duhet të trajtohet në përputhje me pikën IS.AR.210.

Për të lehtësuar krahasueshmërinë e ndërsjellë të vlerësimeve të rreziqeve, caktimi i nivelit të rrezikut për pikën 1 do të marrë parasysh informacionin përkatës të marrë në koordinim me organizatat e përmendura në shkronjën "b".

d) Autoriteti kompetent rishikon dhe përditëson vlerësimin e rrezikut të kryer në përputhje me shkronjat "a", "b" dhe "c" në cilindo nga rastet e mëposhtme:

1. ka një ndryshim në elementet që u nënshtrohen rreziqeve të sigurisë së informacionit;

2. ka një ndryshim në lidhjet ndërmjet organizatës së autoritetit kompetent dhe organizatave të tjera, ose në rreziqet e komunikuara nga organizatat e tjera;

3. ka një ndryshim në informacionin ose njohuritë e përdorura për identifikimin, analizën dhe klasifikimin e rreziqeve;

4. ka mësime të nxjerra nga analiza e incidenteve të sigurisë së informacionit.

IS.AR.210 Trajtimi i rrezikut të sigurisë së informacionit

a) Autoriteti kompetent merr masa për të trajtuar rreziqet e papranueshme të identifikuara në përputhje me pikën IS.AR.205, i zbaton ato në kohën e duhur dhe kontrollon efektivitetin e tyre të vazhdueshëm. Këto masa i mundësojnë autoritetit kompetent, që:

1. të kontrollojë rrethanat që ndikojnë në shfaqjen efektive të skenarit kërcënues;

2. të zvogëlojë pasojat për sigurinë në operim që lidhen me shfaqjen e skenarit kërcënues;

3. të shmangë rreziqet.

Këto masa nuk sjellin ndonjë rrezik të ri të mundshëm të papranueshëm për sigurinë në operim.

b) Personi i përmendur në pikën IS.AR.225(a) dhe stafi tjetër i prekur i autoritetit kompetent njoftohen për rezultatin e vlerësimit të rrezikut të kryer në përputhje me pikën IS.AR.205, skenarët kërcënues përkatës dhe masat që duhen zbatuar.

Autoriteti kompetent informon gjithashtu organizatat me të cilat ka një ndërlidhje në përputhje me pikën IS.AR.205 (b) për çdo rrezik të njohur ndërmjet autoritetit kompetent dhe organizatës.

IS.AR.215 Incidentet e sigurisë së informacionit – zbulimi, reagimi dhe rikuperimi

a) Bazuar në rezultatin e vlerësimit të rrezikut të kryer në përputhje me pikën IS.AR.205 dhe rezultatin e trajtimit të rrezikut të kryer në përputhje me pikën IS.AR.210, autoriteti kompetent zbaton masa për zbulimin e ngjarjeve që tregojnë potencialin e shfaqjes së rreziqeve të papranueshme dhe që mund të kenë një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim. Këto masa zbulimi i mundësojnë autoritetit kompetent, që:

1. të identifikojë devijimet nga linjat bazë të paracaktuara të performancës funksionale;

2. të lëshojë paralajmërimet për të aktivizuar masat e duhura të reagimit, në rast të ndonjë devijimi.

b) Autoriteti kompetent zbaton masa për t'iu përgjigjur të gjitha kushteve të ngjarjeve të identifikuara, në përputhje me shkronjën "a", që mund të shndërrohen ose që janë shndërruar në një incident të sigurisë së informacionit. Këto masa reagimi i mundësojnë autoritetit kompetent, që:

1. të fillojë reagimin e organizatës së tij ndaj paralajmërimeve të përmendura në pikën (a)(2), duke aktivizuar burimet e paracaktuara dhe rendin e veprimeve;

2. të përmbajë përhapjen e një sulmi dhe të shmangë shfaqjen e plotë të një skenari kërcënues;

3. të kontrollojë mënyrën e mosfunksionimit të elementeve të prekura, të përcaktuara në pikën IS.AR.205(a).

c) Autoriteti kompetent zbaton masat që synojnë rikuperimin mbas incidenteve të sigurisë së informacionit, duke përfshirë masat emergjente, nëse është e nevojshme. Këto masa rikuperimi i mundësojnë autoritetit kompetent, që:

1. të eliminojë gjendjen që shkaktoi incidentin, ose ta kufizojë atë në një nivel të tolerueshëm;

2. të rivendosë një gjendje të sigurt të elementeve të prekura, të përcaktuara në pikën IS.AR.205(a) brenda një kohe rikuperimi të përcaktuar më parë nga organizata e tij.

IS.AR.220 Kontraktimi i veprimtarive të menaxhimit të sigurisë së informacionit

Autoriteti kompetent siguron që gjatë kontraktimit të ndonjë pjese të aktiviteteve të përmendura në pikën IS.AR.200 me organizata të tjera, aktivitetet e kontraktuara janë në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe organizata e kontraktuar punon nën mbikëqyrjen e tij.

Autoriteti kompetent siguron që rreziqet që lidhen me aktivitetet e kontraktuara të menaxhohen, siç duhet.

IS.AR.225 Kërkesat e personelit

Autoriteti kompetent do të:

a) ketë një person që ka autoritetin për të krijimin dhe mbarëvajtjen e strukturave organizative, politikave, proceseve dhe procedurave të nevojshme për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Ky person duhet:

1. të ketë autoritet për t'u qasur plotësisht te burimet e nevojshme për autoritetin kompetent për të kryer të gjitha detyrat e kërkuara nga kjo Rregullore;

2. të zotërojë delegimin e kompetencave të nevojshme për të kryer detyrat e caktuara;

b) ketë një proces për t'u siguruar që ai ka staf të mjaftueshëm në detyrë për të kryer aktivitetet e mbuluara nga ky aneks;

c) ketë një proces për t'u siguruar që personeli i përmendur në shkronjën "b" të ketë kompetencën e nevojshme për të kryer detyrat e tyre;

d) ketë një proces për t'u siguruar që personeli të pranojë përgjegjësitë që lidhen me rolet dhe detyrat e caktuara;

e) sigurohet që identiteti dhe besueshmëria e personelit, të cilët kanë akses në sistemet e informacionit dhe të dhënat që u nënshtrohen kërkesave të kësaj Rregulloreje janë përcaktuar siç duhet.

IS.AR.230 Ruajtja e të dhënave

a) Autoriteti kompetent duhet të ruajë të dhënat për aktivitetet e tij të menaxhimit të sigurisë së informacionit.

1. Autoriteti kompetent duhet të sigurohet që të dhënat e mëposhtme të jenë të arkivuara dhe të gjurmueshme:

i. kontratat për aktivitetet e përmendura në pikën IS.AR.200(a)(5);

ii. regjistrimet e proceseve kryesore të referuara në pikën IS.AR.200(d);

iii. të dhënat e rreziqeve të identifikuara në vlerësimin e rrezikut të përmendur në pikën IS.AR.205 së bashku me masat shoqëruese të trajtimit të rrezikut të përmendura në pikën IS.AR.210;

iv. të dhënat e ngjarjeve të sigurisë së informacionit të cilat mund të kenë nevojë të rivlerësohen për të zbuluar incidente ose cenueshmëri të pazbuluara të sigurisë së informacionit.

2. Të dhënat e përmendura në pikën (1)(i) ruhen të paktën deri në 5 vjet pas ndryshimit ose përfundimit të kontratës.

3. Të dhënat e përmendura në pikën (1)(ii) dhe (iii) ruhen të paktën për një periudhë prej 5 vjetësh.

4. Të dhënat e përmendura në pikën (1)(iv) ruhen derisa ato ngjarje të sigurisë së informacionit të rivlerësohen në përputhje me një periodicitet të përcaktuar në një procedurë të vendosur nga Autoriteti kompetent.

b) Autoriteti kompetent duhet të ruajë të dhëna për kualifikimin dhe përvojën e personelit të tij të përfshirë në aktivitetet e menaxhimit të sigurisë së informacionit.

1. Të dhënat e kualifikimit dhe përvojës së personelit ruhen për aq kohë sa personi punon për autoritetin kompetent dhe për të paktën 3 vjet, pasi personi të jetë larguar nga autoriteti kompetent.

2. Anëtarëve të stafit, me kërkesën e tyre, u jepet akses në të dhënat e tyre individuale. Gjithashtu, me kërkesën e tyre, autoriteti kompetent u siguron atyre një kopje të të dhënave të tyre individuale pas largimit nga autoriteti kompetent.

c) Formati i të dhënave duhet të specifikohet në procedurat e autoritetit kompetent.

d) Të dhënat ruhen në një mënyrë që siguron mbrojtje nga dëmtimi, ndryshimi dhe vjedhja, me informacionin që identifikohet, kur kërkohet, sipas nivelit të klasifikimit të sigurisë. Autoriteti kompetent siguron që të dhënat të ruhen, duke përdorur mjete për të siguruar integritetin, autenticitetin dhe aksesin e autorizuar.

IS.AR.235 Përmirësimi i vazhdueshëm

a) Autoriteti kompetent vlerëson, duke përdorur tregues të përshtatshëm të performancës, efektivitetin dhe pjekurinë e ISMS-së së tij. Vlerësimi kryhet mbi një bazë kalendarike të përcaktuar nga autoriteti kompetent ose pas një incidenti të sigurisë së informacionit.

b) Nëse konstatohen mangësi pas vlerësimit të kryer në përputhje me shkronjën "a", autoriteti kompetent merr masat e nevojshme të përmirësimit për të siguruar që ISMS-ja të vazhdojë të jetë në përputhje me kërkesat në fuqi

dhe të mbajë rreziqet e sigurisë së informacionit në një nivel të pranueshëm. Përveç kësaj, autoriteti kompetent rivlerëson ato elemente të ISMS-së të prekura nga masat e miratuara.

ANEKSI II
SIGURIA E INFORMACIONIT – KËRKESAT E ORGANIZATËS

[PJESA-IS.I.OR]

IS.I.OR.100	Fushëveprimi
IS.I.OR.200	Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS)
IS.I.OR.205	Vlerësimi i rrezikut të sigurisë së informacionit
IS.I.OR.210	Trajtimi i rrezikut të sigurisë së informacionit
IS.I.OR.215	Skema e raportimit të brendshëm të sigurisë së informacionit
IS.I.OR.220	Incidentet e sigurisë së informacionit – zbulimi, reagimi dhe rikuperimi
IS.I.OR.225	Përgjigje ndaj gjetjeve të njoftuara nga autoriteti kompetent
IS.I.OR.230	Skema e raportimit të jashtëm të sigurisë së informacionit
IS.I.OR.235	Kontraktimi i aktiviteteve të menaxhimit të sigurisë së informacionit
IS.I.OR.240	Kërkesat e personelit
IS.I.OR.245	Ruajtja e të dhënave
IS.I.OR.250	Manuali i menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMM)
IS.I.OR.255	Ndryshime në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit
IS.I.OR.260	Përmirësimi i vazhdueshëm

IS.I.OR.100 Fushëveprimi

Kjo pjesë përcakton kërkesat që duhet të plotësojnë organizatat e përmendura në nenin 2, pika 1 të kësaj Rregulloreje.

IS.I.OR.200 Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS)

a) Për të arritur objektivat e përcaktuar në nenin 1, organizata duhet të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS), i cili siguron që organizata:

1. vendos një politikë për sigurinë e informacionit duke përcaktuar parimet e përgjithshme të organizatës në lidhje me ndikimin e mundshëm të rreziqeve të sigurisë së informacionit në sigurinë në operim;

2. identifikon dhe rishikon rreziqet e sigurisë së informacionit në përputhje me pikën IS.I.OR.205;

3. përcakton dhe zbaton masat e trajtimit të rrezikut të sigurisë së informacionit, në përputhje me pikën IS.I.OR.210;

4. zbaton një skemë raportimi të brendshëm të sigurisë së informacionit në përputhje me pikën IS.I.OR.215;

5. përcakton dhe zbaton, në përputhje me pikën IS.I.OR.220, masat e nevojshme për zbulimin e ngjarjeve të sigurisë së informacionit, identifikon ato ngjarje që konsiderohen si incidente me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim, me përjashtim të rasteve të lejuara nga pika IS.I.OR.205(e) dhe u përgjigjet dhe merr masa për t'iu përgjigjur këtyre incidenteve dhe për të rikuperuar pas tyre;

6. zbaton masat që janë njoftuar nga autoriteti kompetent si reagim i menjëhershëm ndaj një incidenti ose cenueshmërie të sigurisë së informacionit me ndikim në sigurinë në operim;

7. merr masat e duhura, në përputhje me pikën IS.I.OR.225, për të adresuar gjetjet e njoftuara nga autoriteti kompetent;

8. zbaton një skemë raportimi të jashtëm në përputhje me pikën IS.I.OR.230 për t'i dhënë mundësi autoritetit kompetent të ndërmarrë veprimet e duhura;

9. përputhet me kërkesat e përfshira në pikën IS.I.OR.235, kur kontrakton ndonjë pjesë të aktiviteteve të përmendura në pikën IS.I.OR.200 me organizata të tjera;

10. përputhet me kërkesat e personelit të përcaktuara në pikën IS.I.OR.240;

11. përputhet me kërkesat e ruajtjes së të dhënave të përcaktuara në pikën IS.I.OR.245;

12. monitoron përputhshmërinë e organizatës me kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe jep komente mbi gjetjet te menaxheri përgjegjës për të siguruar zbatimin efektiv të veprimeve korrigjuese;

13. mbron, pa cenuar kërkesat në fuqi të raportimit të incidentit, konfidencialitetin e çdo informacioni që organizata mund të ketë marrë nga organizata të tjera, sipas nivelit të saj të ndjeshmërisë.

b) Për të përmbushur vazhdimisht kërkesat e referuara në nenin 1, organizata zbaton një proces përmirësimi të vazhdueshëm në përputhje me pikën IS.I.OR.260.

c) Organizata dokumenton, në përputhje me pikën IS.I.OR.250, të gjitha proceset kryesore, procedurat, rolet dhe përgjegjësitë e kërkuara për të qenë në përputhje me pikën IS.I.OR.200(a) dhe krijon një proces për ndryshimin e këtij dokumentacioni. Ndryshimet në këto procese, procedura, role dhe përgjegjësi menaxhohen në përputhje me pikën IS.I.OR.255.

d) Proceset, procedurat, rolet dhe përgjegjësitë e përcaktuara nga autoriteti kompetent në zbatim të pikës IS.AR.200(a) përputhen me natyrën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të tij, bazuar në një vlerësim të rreziqeve të sigurisë së informacionit të qenësishme për ato aktivitete, dhe mund të integrohen brenda sistemeve të tjera ekzistuese të menaxhimit të zbatuara tashmë nga autoriteti kompetent.

e) Pa cenuar detyrimin për të përmbushur kërkesat e raportimit të përcaktuara në urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, "Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë" dhe kërkesat e përcaktuara në pikën IS.I.OR.200 (a)(13), organizata mund të lejohet nga autoriteti kompetent që të mos zbatojë kërkesat e përmendura në shkronjat "a" deri në (d) dhe kërkesat përkatëse të përfshira në pikat IS.I.OR.205 deri IS.I.OR.260, nëse tregon në mënyrë të kënaqshme për atë autoritet se aktivitetet, objektet dhe burimet e saj, si dhe shërbimet që ajo operon, ofron, merr dhe mirëmban, nuk paraqesin ndonjë rrezik sigurie informacioni me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim, as për veten dhe as për organizatat e tjera. Miratimi bazohet në një vlerësim të dokumentuar të rrezikut të sigurisë së informacionit të kryer nga organizata ose një palë e tretë në përputhje me pikën IS.I.OR.205 dhe të rishikuar dhe miratuar nga autoriteti i saj kompetent.

Vlefshmëria e vazhdueshme e atij miratimi rishikohet nga autoriteti kompetent pas ciklit të zbatueshëm të auditimit të mbikëqyrjes dhe sa herë që zbatohen ndryshime në fushën e punës së organizatës.

IS.I.OR.205 Vlerësimi i rrezikut të sigurisë së informacionit

a) Organizata duhet të identifikojë të gjitha elementet e saj që mund të ekspozohen ndaj rreziqeve të sigurisë së informacionit. Kjo përfshin:

1. aktivitetet, objektet dhe burimet e organizatës, si dhe shërbimet që organizata operon, ofron, merr ose mirëmban;

2. pajisjet, sistemet, të dhënat dhe informacionet që ndikojnë në funksionimin e elementeve të renditura në pikën 1.

b) Organizata duhet të identifikojë ndërlidhjet që ka me organizatat e tjera dhe që mund të rezultojë në ekspozimin e ndërsjellë ndaj rreziqeve të sigurisë së informacionit.

c) Për elementet dhe ndërlidhjet e përmendura në shkronjat "a" dhe "b", organizata identifikon rreziqet e sigurisë së informacionit që mund të kenë një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim. Për çdo rrezik të identifikuar, organizata duhet:

1. të caktojë një nivel rreziku sipas një klasifikimi të paracaktuar të vendosur nga organizata;

2. të lidhë çdo rrezik dhe nivelin e tij me elementin ose ndërlidhjen përkatëse të identifikuar në përputhje me shkronjat "a" dhe "b".

Klasifikimi i paracaktuar i referuar në pikën 1 merr parasysh potencialin e shfaqjes së skenarit kërcënues dhe ashpërsinë e pasojave të tij mbi sigurinë në operim. Nëpërmjet këtij klasifikimi, dhe duke marrë parasysh nëse organizata ka një proces të strukturuar dhe të përsëritshëm të menaxhimit të rrezikut për operacionet, organizata është në gjendje të përcaktojë nëse rreziku është i pranueshëm ose duhet të trajtohet në përputhje me pikën IS.AR.210.

Për të lehtësuar krahasueshmërinë e ndërsjellë të vlerësimeve të rreziqeve, caktimi i nivelit të rrezikut për pikën 1 do të marrë parasysh informacionin përkatës të marrë në koordinim me organizatat e përmendura në shkronjën "b".

d) Organizata rishikon dhe përditëson vlerësimin e rrezikut të kryer në përputhje me shkronjat "a", (b) dhe, sipas rastit, shkronjat "c" ose "e" në cilindo nga rastet e mëposhtme:

1. ka një ndryshim në elementet që u nënshtrohen rreziqeve të sigurisë së informacionit;

2. ka një ndryshim në ndërlidhjet ndërmjet organizatës së autoritetit kompetent dhe organizatave të tjera, ose në rreziqet e komunikuara nga organizatat e tjera;

3. ka një ndryshim në informacionin ose njohuritë e përdorura për identifikimin, analizën dhe klasifikimin e rreziqeve;

4. ka mësime të nxjerra nga analiza e incidenteve të sigurisë së informacionit.

e) Me përjashtim nga shkronja "c", organizatave që u kërkohet të pajtohen me nënpjesën C të aneksit III (pjesa-ATM/ANS.OR) të urdhrit të ministrit nr. 193, datë 6.10.2022, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre", të ndryshuar, do të zëvendësojnë analizën e ndikimit në sigurinë në operim me një analizë të ndikimit në shërbimet e tyre sipas vlerësimit të mbështetjes së sigurisë në operim që kërkohet nga pika ATM/ANS.OR.C.005. Ky vlerësim mbështetës i sigurisë në operim do t'u vihet në dispozicion ofruesve të shërbimeve të trafikut ajror të cilëve ata u ofrojnë shërbime dhe ata ofrues të shërbimeve të trafikut ajror do të jenë përgjegjës për vlerësimin e ndikimit në sigurinë e aviacionit.

IS.I.OR.210 Trajtimi i rrezikut të sigurisë së informacionit

a) Organizata merr masa për të trajtuar rreziqet e papranueshme të identifikuara në përputhje me pikën IS.OR.205, i zbaton ato në kohën e duhur dhe kontrollon efektivitetin e tyre të vazhdueshëm. Këto masa i mundësojnë autoritetit kompetent, që:

1. të kontrollojë rrethanat që ndikojnë në shfaqjen efektive të skenarit kërcënues;

2. të zvogëlojë pasojat për sigurinë në operim që lidhen me shfaqjen e skenarit kërcënues;

3. të shmangë rreziqet.

Këto masa nuk sjellin ndonjë rrezik të ri të mundshëm të papranueshëm për sigurinë në operim.

b) Personi i përmendur në pikën IS.I.OR.225 (a) dhe (b) dhe stafi tjetër i prekur i autoritetit kompetent njoftohen për rezultatin e vlerësimit të rrezikut të kryer në përputhje me pikën IS.OR.205, skenarët kërcënues përkatës dhe masat që duhen zbatuar.

Organizata informon, gjithashtu, organizatat me të cilat ka një ndërlidhje në përputhje me pikën IS.OR.205 (b) për çdo rrezik të njohur ndërmjet dy organizatave.

IS.I.OR.215 Skema e raportimit të brendshëm të sigurisë së informacionit

a) Organizata krijon një skemë të brendshme raportimi për të mundësuar mbledhjen dhe vlerësimin e ngjarjeve të sigurisë së informacionit, duke përfshirë ato që raportohen në përputhje me pikën IS.I.OR.230.

b) Kjo skemë dhe procesi i përmendur në pikën IS.I.OR.220 i mundësojnë organizatës, që:

1. të identifikojë se cilat nga ngjarjet e raportuara në përputhje me shkronjën "a" konsiderohen si incidente ose cenueshmëri të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim;

2. të identifikojë shkaqet dhe faktorët që ndikojnë në incidentet dhe cenueshmëritë e sigurisë së informacionit të identifikuara në përputhje me pikën 1, dhe t'i trajtojë ato si pjesë e procesit të menaxhimit të rrezikut të sigurisë së informacionit në përputhje me pikat IS.I.OR.205 dhe IS.I.OR.220;

3. të sigurojë një vlerësim të të gjithë informacionit përkatës të njohur, në lidhje me incidentet dhe cenueshmëritë e sigurisë së informacionit të identifikuara në përputhje me pikën 1;

4. të sigurojë zbatimin e një metode për shpërndarjen e brendshme të informacionit sipas nevojës;

c) Çdo organizate të kontraktuar, e cila mund ta ekspozojë organizatën ndaj rreziqeve të sigurisë së informacionit me një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim do t'i kërkohet të raportojë ngjarjet e sigurisë së informacionit tek organizata. Këto raporte dorëzohen duke përdorur procedurat e përcaktuara në marrëveshjet specifike kontraktuale dhe vlerësohen në përputhje me shkronjën "b".

d) Organizata bashkëpunon në hetime me çdo organizatë tjetër që ka një kontribut të rëndësishëm në sigurinë e informacionit të aktiviteteve të saj.

e) Organizata mund ta integrojë atë skemë raportimi me skema të tjera raportimi që ajo ka zbatuar tashmë.

IS.I.OR.220 Incidentet e sigurisë së informacionit – zbulimi, reagimi dhe rikuperimi

a) Bazuar në rezultatin e vlerësimit të rrezikut të kryer në përputhje me pikën IS.AR.205 dhe rezultatin e trajtimit të rrezikut të kryer në përputhje me pikën IS.AR.210, organizata do të zbatojë masa për zbulimin e ngjarjeve që tregojnë potencialin e shfaqjes së rreziqeve të papranueshme dhe që mund të kenë një ndikim të mundshëm në sigurinë në operim. Këto masa zbulimi i mundësojnë autoritetit kompetent, që:

1. të identifikojë devijimet nga linjat bazë të paracaktuara të performancës funksionale;

2. të lëshojë paralajmërimet për të aktivizuar masat e duhura të reagimit, në rast të ndonjë devijimi.

b) Organizata zbaton masa për t'iu përgjigjur të gjitha kushteve të ngjarjeve të identifikuara në përputhje me shkronjën "a" që mund të shndërrohen ose që janë shndërruar në një incident të sigurisë së informacionit. Këto masa reagimi i mundësojnë organizatës, që:

1. të fillojë reagimin ndaj paralajmërimeve të përmendura në pikën (a)(2), duke aktivizuar burimet e paracaktuara dhe rendin e veprimeve;

2. të përmbajë përhapjen e një sulmi dhe të shmangë shfaqjen e plotë të një skenari kërcënues;

3. të kontrollojë mënyrën e mosfunksionimit të elementeve të prekura, të përcaktuara në pikën IS.I.OR.205(a).

c) Organizata zbaton masat që synojnë rikuperimin mbas incidenteve të sigurisë së informacionit, duke përfshirë masat emergjente, nëse është e nevojshme. Këto masa rikuperimi i mundësojnë organizatës, që:

1. të eliminojë gjendjen që shkaktoi incidentin, ose ta kufizojë atë në një nivel të tolerueshëm;

2. të rivendosë një gjendje të sigurt të elementeve të prekura, të përcaktuara në pikën IS.I.OR.205(a) brenda një kohe rikuperimi të përcaktuar më parë nga organizata e saj.

IS.I.OR.225 Përgjigje ndaj gjetjeve të njoftuara nga autoriteti kompetent

a) Pas marrjes së njoftimit për gjetjet e dorëzuar nga autoriteti kompetent, organizata duhet:

1. të identifikojë shkakun ose shkaqet rrënjësore dhe faktorët që ndikojnë në mospërputhje;

2. të përcaktojë një plan veprimi korrigjues;

3. të vërtetojë korrigjimin e mospërputhjes në mënyrë të kënaqshme për autoritetin kompetent.

b) Veprimet e përmendura në shkronjën "a" kryhen brenda periudhës së rënë dakord me autoritetin kompetent.

IS.I.OR.230 Skema e raportimit të jashtëm të sigurisë së informacionit

a) Organizata zbaton një sistem raportimi të sigurisë së informacionit që përputhet me kërkesat e përcaktuara në urdhrin e ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, "Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë" dhe çdo ndryshim të tij, nëse kjo Rregullore është e zbatueshme për organizatën.

b) Pa cenuar detyrimet e urdhrit të ministrit nr. 89, datë 5.5.2022, "Për miratimin e rregullores për raportimin dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil në Republikën e Shqipërisë", organizata duhet të sigurojë që çdo incident ose cenueshmëri e sigurisë së informacionit, që mund të përfaqësojë një rrezik të rëndësishëm për sigurinë në operim, t'i raportohet autoritetit të saj kompetent. Për më tepër:

1. Kur një incident ose cenueshmëri e tillë prek një avion ose sistem ose komponent përkatës, organizata duhet t'ia raportojë, gjithashtu, mbajtësit të miratimit të projektimit;

2. Kur një incident ose cenueshmëri e tillë prek një sistem ose përbërës të përdorur nga organizata, organizata duhet t'ia raportojë atë organizatës përgjegjëse për projektimin e sistemit, ose përbërësit.

c) Organizata duhet të raportojë situatat e përmendura në shkronjën "b", si më poshtë:

1. një njoftim i dorëzohet autoritetit kompetent dhe, sipas rastit, mbajtësit të miratimit të projektimit ose organizatës përgjegjëse për projektimin e sistemit ose përbërësit, sapo organizata të vihet në dijeni për situatën;

2. një raport i dorëzohet autoritetit kompetent dhe, sipas rastit, mbajtësit të miratimit të projektimit ose organizatës përgjegjëse për projektimin e sistemit, ose përbërësit, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më shumë se 72 orë nga koha kur organizata vihet në dijeni të situatës,

përveç rasteve kur rrethanat e jashtëzakonshme e pengojnë këtë.

Raporti bëhet në formën e përcaktuar nga autoriteti kompetent dhe përmban të gjithë informacionin përkatës për situatën e njohur për organizatën;

3. një raport pasues i dorëzohet autoritetit kompetent dhe, sipas rastit, mbajtësit të miratimit të projektimit ose organizatës përgjegjëse për projektimin e sistemit, ose përbërësit, duke ofruar detaje të veprimeve që organizata ka ndërmarrë, ose synon të ndërmarrë për të rikuperuar pas incidentit dhe veprimet që synon të ndërmarrë për të parandaluar incidente të ngjashme të sigurisë së informacionit në të ardhmen.

Raporti pasues dorëzohet sapo të jenë identifikuar këto veprime dhe përgatitet në formën e përcaktuar nga autoriteti kompetent.

IS.I.OR.235 Kontraktimi i veprimtarive të menaxhimit të sigurisë së informacionit

a) Organizata siguron që gjatë kontraktimit të ndonjë pjese të aktiviteteve të përmendura në pikën IS.I.OR.200 me organizata të tjera, aktivitetet e kontraktuara janë në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe organizata e kontraktuar punon nën mbikëqyrjen e saj. Organizata siguron që rreziqet që lidhen me aktivitetet e kontraktuara të menaxhohen siç duhet.

b) Organizata duhet të sigurojë që autoriteti kompetent të ketë akses nëpërmjet një kërkese ndaj organizatës së kontraktuar për të përcaktuar pajtueshmërinë e vazhdueshme me kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në këtë Rregullore.

IS.I.OR.240 Kërkesat e personelit

a) Menaxheri përgjegjës i organizatës i caktuar në përputhje me urdhrin e ministrit nr. 79, datë 15.4.2024, "Për miratimin e rregullores mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra", urdhrin e ministrit nr. 80, datë 30.6.2023, "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore", i ndryshuar; urdhrin e ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil", i ndryshuar; urdhrin e ministrit nr. 171, datë 11.11.2025, "Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e kërkesave teknike edhe procedurave administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror"; urdhrin e ministrit nr. 193, datë 6.10.2022, "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre", i ndryshuar; ose urdhrin e ministrit nr. 119, datë 29.9.2023, "Për miratimin e rregullores mbi kuadrin rregullator për hapësirën – U të hapësirës ajrore", siç është e zbatueshme e përmendur në nenin 2, pika 1 të kësaj Rregulloreje do të ketë autoritetin e korporatës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e kërkuara nga kjo Rregullore të mund të financohen dhe kryhen. Ai person:

1. siguron që të gjitha burimet e nevojshme janë në dispozicion për të përmbushur kërkesat e kësaj Rregulloreje;

2. krijon dhe promovon politikën e sigurisë së informacionit të përmendur në pikën IS.I.OR.200(a)(1);

3. demonstron një njohuri bazë të kësaj Rregulloreje.

b) Menaxheri përgjegjës cakton një person ose grup personash për t'u siguruar që organizata është në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe përcakton shtrirjen e autoritetit të tyre. Ai person ose grup personash i raporton drejtpërdrejt menaxherit përgjegjës dhe do të ketë njohuritë, përgatitjen dhe përvojën e duhur për të përmbushur përgjegjësitë e tyre. Në procedurë përcaktohet se kush e zëvendëson një person të caktuar në rast të mungesës së gjatë të atij personi.

c) Menaxheri përgjegjës emëron një person ose grup personash me përgjegjësinë për të menaxhuar funksionin e monitorimit të pajtueshmërisë të përmendur në pikën IS.I.OR.200(a)(12).

d) Kur organizata ndan strukturat organizative të sigurisë së informacionit, politikat, proceset dhe procedurat me organizata të tjera ose me pjesë të organizatës së tyre që nuk janë pjesë e miratimit, ose deklaratës, menaxheri përgjegjës mund t'ia delegojë aktivitetet e tij një personi përgjegjës të përbashkët.

Në një rast të tillë, krijohen masa koordinuese ndërmjet menaxherit përgjegjës të organizatës dhe personit të përbashkët përgjegjës për të siguruar integrimin e duhur të menaxhimit të sigurisë së informacionit brenda organizatës.

e) Menaxheri përgjegjës ose personi përgjegjës i përbashkët i përmendur në shkronjën "d" do të ketë autoritetin e korporatës për të krijuar dhe mirëmbajtur strukturat organizative, politikat, proceset dhe procedurat e nevojshme për zbatimin e pikës IS.I.OR.200.

f) Organizata duhet të ketë një proces për të siguruar që ka staf të mjaftueshëm në detyrë për të kryer aktivitetet e mbuluara nga ky aneks.

g) Organizata duhet të ketë një proces për të siguruar që stafi i përmendur në shkronjën "f" të ketë kompetencën e nevojshme për të kryer detyrat e tyre.

h) Organizata duhet të ketë një proces për të siguruar që stafi të pranojë dhe kuptojë përgjegjësitë që lidhen me rolet dhe detyrat e caktuara.

i) Organizata duhet të sigurohet që identiteti dhe besueshmëria e personelit të cilët kanë akses në sistemet e informacionit dhe të dhënat që u nënshtrohen kërkesave të kësaj Rregulloreje janë përcaktuar siç duhet.

IS.I.OR.245 Ruajtja e të dhënave

a) *Organizata duhet të ruajë të dhënat për aktivitetet e saj të menaxhimit të sigurisë së informacionit*

1. organizata duhet të sigurohet që të dhënat e mëposhtme të jenë të arkivuara dhe të gjurmueshme:

i. çdo miratim i marrë dhe çdo vlerësim shoqërues i rrezikut të sigurisë së informacionit në përputhje me pikën IS.I.OR.200(e);

ii. kontratat për aktivitetet e përmendura në pikën IS.I.OR.200(a)(9);

iii. të dhënat e proceseve kryesore të përmendura në pikën IS.I.OR.200(d);

iv. të dhënat e rreziqeve të identifikuara në vlerësimin e rrezikut të përmendur në pikën IS.I.OR.205, së bashku me masat shoqëruese të trajtimit të rrezikut të përmendura në pikën IS.I.OR.210;

v. të dhënat e incidenteve dhe cenueshmërive të sigurisë së informacionit të raportuara në përputhje me skemat e raportimit të përmendura në pikat IS.I.OR.215 dhe IS.I.OR.230;

vi. të dhënat e atyre ngjarjeve të sigurisë së informacionit që mund të kenë nevojë të rivlerësohen për të zbuluar incidente ose cenueshmëri të pazbuluara të sigurisë së informacionit.

2. të dhënat e përmendura në pikën (1)(i) ruhen të paktën deri në 5 vjet pasi miratimi të ketë humbur vlefshmërinë e tij;

3. të dhënat e përmendura në pikën (1)(ii) ruhen të paktën deri në 5 vjet pas ndryshimit ose përfundimit të kontratës;

4. të dhënat e përmendura në pikën (1)(iii), (iv) dhe (v) ruhen të paktën për një periudhë prej 5 vjetësh;

5. të dhënat e përmendura në pikën (1)(vi) mbahen derisa ato ngjarje të sigurisë së informacionit të rivlerësohen në përputhje me një periodicitet të përcaktuar në një procedurë të vendosur nga organizata;

b) *Organizata duhet të ruajë të dhëna për kualifikimin dhe trajnimin e stafit të vet të përfshirë në aktivitetet e menaxhimit të informacionit*

1. të dhënat e kualifikimit dhe përvojës së personelit ruhen për aq kohë sa personi punon për organizatën dhe për të paktën 3 vjet pasi personi të jetë larguar nga organizata.

2. anëtarëve të stafit, me kërkesën e tyre, u jepet akses në të dhënat e tyre individuale. Gjithashtu, me kërkesën e tyre, organizata do t'u sigurojë atyre një kopje të të dhënave të tyre individuale pas largimit nga organizata.

c) Formati i të dhënave duhet të specifikohet në procedurat e organizatës.

d) Të dhënat ruhen në një mënyrë që siguron mbrojtje nga dëmtimi, ndryshimi dhe vjedhja, me informacionin që identifikohet, kur kërkohet, sipas nivelit të klasifikimit të sigurisë. Organizata siguron që të dhënat të ruhen duke përdorur mjete për të siguruar integritetin, autenticitetin dhe aksesin e autorizuar.

IS.I.OR.250 Manuali i menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMM)

a) Organizata duhet t'i vërë në dispozicion autoritetit kompetent një manual për menaxhimin e sigurisë së informacionit (ISMM) dhe, sipas rastit, çdo manual përkatës dhe procedurë të përmendur, që përmban:

1. një deklaratë e nënshkruar nga menaxheri përgjegjës që konfirmon se organizata do të punojë në çdo kohë në përputhje me këtë aneks dhe me ISMM; nëse menaxheri i përgjegjshëm nuk është drejtori ekzekutiv (CEO) i organizatës, atëherë CEO duhet të bashkëfirmosë deklaratën;

2. titullin/jt, emrin/at, detyrat, llogaridhënien, përgjegjësitë dhe autorizimet e personit ose

personave të përcaktuar në pikën IS.I.OR.240(b) dhe (c);

3. titullin, emrin, detyrat, llogaridhënien, përgjegjësitë dhe autoritetin e personit përgjegjës të përbashkët të përcaktuar në pikën IS.I.OR.240(d), sipas rastit;

4. politikën e sigurisë së informacionit të organizatës siç referohet në pikën IS.I.OR.200(a)(1);

5. një përshkrim të përgjithshëm të numrit dhe kategorive të personelit dhe të sistemit të vendosur për të planifikuar disponueshmërinë e personelit siç kërkohet nga pika IS.I.OR.240;

6. titujt, emrat, detyrat, llogaridhënien, përgjegjësitë dhe autoritetet e personave kryesorë përgjegjës për zbatimin e pikës IS.I.OR.200, duke përfshirë personin ose personat përgjegjës për funksionin e monitorimit të përputhshmërisë të përmendur në pika IS.I.OR.200(a)(12);

7. një organigramë që tregon zinxhirët përkatës të llogaridhënies dhe përgjegjësisë për personat e përmendur në pikat 2 dhe 6;

8. përshkrimin e skemës së raportimit të brendshëm të referuar në pikën IS.I.OR.215;

9. procedurat që përcaktojnë se si organizata siguron përputhjen me këtë pjesë, dhe në veçanti:

i. dokumentacionin e përmendur në pikën IS.I.OR.200(c);

ii. procedurat që përcaktojnë se si organizata kontrollon çdo aktivitet të kontraktuar, siç përmendet në pikën IS.I.OR.200(a)(9);

iii. procedurën e ndryshimit të ISMM-së të përmendur në shkronjën "c".

10. detajet e mjeteve alternative të pajtueshmërisë të miratuara aktualisht.

b) Botimi fillestar i ISMM-së do të miratohet dhe një kopje do të mbahet nga autoriteti kompetent. Për organizatat e deklaruara nuk do të kërkohet miratim. ISMM do të ndryshohet sipas nevojës për të mbetur një përshkrim i përditësuar i ISMMS-së së organizatës; një kopje e çdo ndryshimi në ISMM duhet t'i jepet autoritetit kompetent.

c) Ndryshimet në ISMM do të menaxhohen sipas procedurës së përcaktuar nga organizata. Çdo ndryshim që nuk përfshihet në objektin e kësaj procedure dhe çdo ndryshim në lidhje me ndryshimet e përmendura në pikën IS.I.OR.255(b) do të miratohet nga autoriteti kompetent. Për organizatat e deklaruara nuk do të kërkohet miratim.

d) Organizata mund të integrojë ISMM-në me prezantime ose manuale të tjera menaxheriale që disponon, me kusht që të ketë një referencë të qartë të kryqëzuar që tregon se cilat pjesë të prezantimit, ose manualit të menaxhimit përputhen me kërkesat e ndryshme të përfshira në këtë Aneks.

IS.I.OR.255 Ndryshime në sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit

a) Ndryshimet në ISMS mund të kryhen dhe t'i njoftohen autoritetit kompetent në një procedurë të zhvilluar nga organizata. Kjo procedurë miratohet nga autoriteti kompetent, duke përjashtuar organizatat e deklaruara.

b) Në lidhje me ndryshimet në ISMS që nuk mbulohen nga procedura e përmendur në shkronjën "a", organizata duhet të aplikojë dhe të marrë një miratim të lëshuar nga autoriteti kompetent, duke përjashtuar organizatat e deklaruara, për të cilat nuk kërkohet miratim.

Në lidhje me këto ndryshime:

1. aplikimi duhet të dorëzohet përpara se të ndodhë një ndryshim i tillë, në mënyrë që t'i mundësojë autoritetit kompetent të përcaktojë pajtueshmërinë e vazhdueshme me këtë Rregullore dhe të ndryshojë, nëse është e nevojshme, certifikatën e organizatës dhe kushtet përkatëse të miratimit që i bashkëlidhen;

2. organizata do të vërë në dispozicion të autoritetit kompetent çdo informacion që kërkon për të vlerësuar ndryshimin;

3. ndryshimi do të zbatohet vetëm pas marrjes së një miratimi zyrtar nga autoriteti kompetent, duke përjashtuar organizatat e deklaruara, të cilat mund ta zbatojnë ndryshimin menjëherë;

4. organizata do të operojë sipas kushteve të përcaktuara nga autoriteti kompetent gjatë zbatimit të këtyre ndryshimeve.

IS.I.OR.260 Përmirësimi i vazhdueshëm

a) Organizata vlerëson, duke përdorur tregues të përshtatshëm të performancës, efektivitetin dhe pjekurinë e ISMS-së së saj. Vlerësimi kryhet mbi një bazë kalendarike të përcaktuar nga autoriteti kompetent ose pas një incidenti të sigurisë së informacionit.

b) Nëse konstatohen mangësi pas vlerësimit të kryer në përputhje me shkronjën "a", organizata merr masat e nevojshme të përmirësimit për të siguruar që ISMS-ja të vazhdojë të jetë në përputhje me kërkesat në fuqi dhe të mbajë

rreziqet e sigurisë së informacionit në një nivel të pranueshëm. Përveç kësaj, organizata do të rivlerësojë ato elemente të ISMS-së të prekura nga masat e miratuara.

URDHËR
Nr. 252, datë 24.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në ligjin 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të RSH-së", në nenet 22 e vijuese të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; në ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; në ligjin nr. 162/2020, "Për prokurimin publik"; dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 14.12.2021, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si vijon:

a) realizimin e procedurave të prokurimit publik me fonde buxhetore të institucionit;

b) dërgimin me shërbim të punonjësve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme jashtë qendrës së punës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në largësi mbi 100 km, si dhe me shërbim jashtë vendit;

c) nënshkrimin e kontratave administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

4. Urdhri nr. 1089, datë 3.11.2025, "Për delegim kompetencash", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Ferit Hoxha

URDHËR
Nr. 253, datë 24.3.2026

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS SË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME NË PROCESET GJYQËSORE

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në ligjin nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të RSH-së"; në ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; në nenet 22 e vijuese të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për përfaqësimin ligjor të institucionit në proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit dhe në Gjykatën Kushtetuese.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në proceset gjyqësorë të nënshkruhen nga Sekretari i Përgjithshëm në emër të personit, apo personave që do përfaqësojnë institucionin.

3. Përfaqësuesi i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural të parashikuar nga legjislacioni në fuqi përpara gjykatave, prokurorisë, zyrave të përmbarimit gjyqësor, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

4. Të gjitha aktet e nënshkruara përpara hyrjes në fuqi të këtij urdhri dhe që janë nxjerrë në zbatim të urdhrit nr. 1091, datë 3.11.2025, "Për delegimin e kompetencës së përfaqësimit ligjor të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në proceset gjyqësore", do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në përfundimin e procesit gjyqësor përkatës.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

6. Urdhri nr. 1091, datë 3.11.2025, "Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Ministrisë për

Evropën dhe Punët e Jashtme në proceset gjyqësore", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Ferit Hoxha

URDHËR
Nr. 254, datë 24.3.2026

PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË DHE DETYRAVE PËR ZËVENDËSMINISTRIN PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28, 29 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të neneve 3, 5 dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000/2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të nenit 15, të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510, date 25.9.2025, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme",

URDHËROJ:

1. Znj. Megi Fino, zëvendësministre në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, gjatë ushtrimit të detyrës të ndjekë dhe të përgjigjet para ministrit për çështjet e mëposhtme:

a) Ndjekjen, koordinimin, monitorimin dhe raportimin mbi ecurinë e zbatimit të angazhimeve në kuadrin e procesit të integrimit evropian, si dhe përgatitjen e raporteve për Kuvendin, Këshillin e Ministrave dhe institucionet e Bashkimit Evropian, në lidhje me këtë proces;

b) Zhvillimin e konsultimeve politike dypalëshe, ku kërkohet në nivel zëvendësministri;

c) Përfaqësimi në marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare në nivel zëvendësministri;

d) Ndjekjen, koordinimin, monitorimin dhe raportimin mbi çështjet e politikave të sigurisë.

2. Zëvendësministri, përveç detyrave të përmendura në këtë urdhër, ndjek çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga ministri.

3. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon me zëvendësministrat e tjerë, për çështje të caktuara që ndërlidhen në fushën e përgjegjësisë së 2 (dy) ose më shumë zëvendësministrave.

4. Ngarkohet zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme me zbatimin e këtij urdhri, si dhe Drejtoria e Sekretarisë dhe e Komunikimit Qendror për njoftimin e tij.

5. Urdhri nr. 1062, datë 28.10.2025, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë dhe delegimin e kompetencave të zëvendësministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Ferit Hoxha

URDHËR
Nr. 255, datë 24.3.2026

PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË DHE DETYRAVE PËR ZËVENDËSMINISTRIN PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; neneve 3, 5 dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000/2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të nenit 15, të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 25.9.2025, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme",

URDHËROJ:

1. Znj. Miriam Shyti, zëvendësministre në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, gjatë ushtrimit të detyrës të ndjekë dhe të përgjigjet para ministrit për çështjet e mëposhtme:

a) Ndjekjen, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të politikave për diasporën dhe koordinimin me institucionet e tjera përgjegjëse, për këto politika;

b) Përgatitjen dhe ndjekjen e zbatimit të platformës së diplomacisë ekonomike dhe kulturore;

c) Zhvillimin e konsultimeve politike dypalëshe, në lidhje me çështje të diasporës, diplomacisë ekonomike dhe kulturore, ku kërkohet nivel zëvendësministri;

d) Ndjekjen e aplikimit të metodave inovative dhe diplomacisë digjitale në aktivitetin e shërbimit të jashtëm.

2. Zëvendësministri, përveç detyrave të përmendura në këtë urdhër, ndjek çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga ministri.

3. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon me zëvendësministrat e tjerë për çështje të caktuara që ndërlidhen në fushën e përgjegjësisë së 2 (dy) ose më shumë zëvendësministrave.

4. Ngarkohet zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme me zbatimin e këtij urdhri, si dhe Drejtoria e Sekretarisë dhe e Komunikimit Qendror për njoftimin e tij.

5. Urdhri nr. 1064, datë 28.10.2025, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë dhe delegimin e kompetencave për zëvendësministrat për Evropën dhe Punët e Jashtme", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Ferit Hoxha

URDHËR
Nr. 256, datë 24.3.2026

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS SË MINISTRIT PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME MBI ÇËSHTJET KONSULLORE

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenet 22 e vijuese të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; në ligjin nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të RSH-së"; në ligjin nr. 8372 datë 9.7.1998, "Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore"; në ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, sipas përcaktimeve të këtij urdhri.

2. Drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Konsullore është personi përgjegjës për nënshkrimin e akteve vijuese:

a) Përcjellje e akteve të gjendjes civile, lejeve të drejtimit, pasaportave sendeve të humbura, specimene të dokumenteve shqiptare apo të huaja;

b) Verifikim dokumentacioni (të lëshuara nga institucionet shqiptare):

- për identitetin e shtetasit shqiptarë;
- për figurën e kandidatit për konsuj nderi të RSH-së dhe të huaj;

c) Kërkesat për çelje-mbyllje aksesesh për diplomatët, operatorë tek Identitek, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë;

d) Shkresa shoqëruese për postën diplomatike që përmban pasaporta dhe materiale të Identitekut.

e) Përcjellje praktikash për heqjen dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare;

f) Përcjellje kërkesash për ekstradim, ndihmë juridike, ndalim, arrestim për shtetas shqiptar e të huaj.

3. Sekretarit të Përgjithshëm i delegohet kompetenca për nënshkrimin e të gjitha akteve të tjera me karakter konsullor, që nuk përfshihen në pikën 2 të këtij urdhri.

4. Njoftimet dhe komunikimet elektronike, për çështjet konsullore, i drejtohen drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, duke vënë në dijeni Sekretarin e Përgjithshëm.

5. Të gjitha njoftimet/publikimet e aktiviteteve /njoftimeve konsullore në faqet, apo llogaritë zyrtare të rrjeteve sociale të MEPJ-së, si dhe të misioneve diplomatike/posteve konsullore të RSH-së, bëhen me miratimin e Sekretarit të Përgjithshëm, me propozim të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, në bashkëpunim me kabinetin e ministrit.

6. Titullarët e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore të Republikës së Shqipërisë i raportojnë për veprimtarinë konsullore, në bazë ditore, drejtorit të drejtorisë që mbulon çështjet konsullore.

7. Drejtori i drejtorisë, që mbulon çështjet konsullore, i raporton në bazë ditore veprimtarinë konsullore, të ushtruar nga përfaqësitë/postet konsullore, Sekretarit të Përgjithshëm.

8. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, titullarët dhe punonjësit konsullorë në misionet diplomatike dhe postet konsullore të RSH-së, si dhe Drejtoria e Sekretarisë dhe Komunikimit Qendror.

9. Ky urdhër u njoftohet strukturave të ngarkuara dhe misioneve diplomatike e konsullore, Sektori i Menaxhimit të Dokumentacionit në Drejtorinë e Sekretarisë dhe Komunikimit Qendror.

10. Urdhri nr. 1090, datë 3.11.2025, "Për delegimin e kompetencës së ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi Çështjet Konsullore", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Ferit Hoxha

URDHËR
Nr. 260, datë 25.3.2026

PËR CAKTIMIN E FUSHËS SE PËRGJEGJËSISË DHE DETYRAVE PËR ZËVENDËSMINISTRIN PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Ne mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28, 29 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të neneve 3, 5 dhe pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000/2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të nenit 15, të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë", si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 25.9.2025, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme",

URDHËROJ:

1. Znj. Vilma Premti, zëvendësministre në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, gjatë ushtrimit të detyrës të ndjekë dhe të përgjigjet para ministrit për çështjet e mëposhtme:

a) Ndjekjen e zbatimit të prioriteteve dhe të objektivave të Shërbimit të Jashtëm, me qëllim energjezimin e strukturave, monitorimin, ndjekjen e politikave dhe praktikave të burimeve njerëzore, në përputhje me kuadrin ligjor që rregullon shërbimin e jashtëm;

b) Ndjekjen dhe mbikëqyrjen e politikave dhe veprimtarisë konsullore, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe eficiencës së shërbimeve ndaj qytetarëve;

c) Ndjekjen e procesit të hartimit dhe të zbatimit të politikave dhe akteve ligjore, në përputhje me prioritetet dhe objektivat e përcaktuar në aktet rregullatore përkatëse;

d) Koordinimin dhe ndjekjen e procesit të hartimit të akteve dhe procedurave administrative të brendshme, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në praktikë.

2. Zëvendësministri, përveç detyrave të përmendura në këtë urdhër, ndjek çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga ministri.

3. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon me zëvendësministrat e tjerë për çështje të caktuara që ndërlidhen në fushën e përgjegjësisë se 2 (dy) ose më shume zëvendësministrave.

4. Ngarkohet zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme me zbatimin e këtij urdhri, si dhe Drejtoria e Sekretarisë dhe e Komunikimit Qendror për njoftimin e tij.

5. Urdhri nr. 1063, datë 28.10.2025, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë dhe delegimin e kompetencave për zëvendësministrat për Evropën dhe Punët e Jashtme", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Ferit Hoxha

URDHËR
Nr. 63, datë 27.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të ligjit nr. 124/2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale"; si dhe Rregullores së Brendshme të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, miratuar me urdhrin e Komisionerit nr. 46, datë 16.2.2024, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave për nënshkrimin e akteve administrative me karakter të përgjithshëm në kompetencë të titullarit/ Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas legjislacionit të zbatueshëm dhe rregullores së institucionit, te znj. Blerta Nerguti, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, duke filluar nga data 30.3.2026 deri më datë 3.4.2026.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe drejtorët e përgjithshëm pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi

VENDIM
Nr. 10, datë 27.3.2026

PËR ANËTARËSIMIN E BANKËS JET SHA NË SKEMËN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE DHE DHËNIEN E CERTIFIKATËS PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 19, të nenit 22, pika 5 dhe pika 6 të nenit 23, dhe të nenit 52, pika 1, shkronja "p", të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar; të nenit 22 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 7, pika 2 dhe pika 3, të udhëzimit nr. 3241, datë 18.12.2014, "Për sigurimin e depozitave në banka", të ndryshuar; të nenit 7, pika 4, të nenit 9, pika 3, të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018; të nenit 6/1, shkronja "e", të rregullores nr. 20, datë 25.9.2017, "Për nënshkrimet e autorizuara në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave", të ndryshuar; të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 31, datë 10.10.2025, "Për caktimin e z. Martin Blushi, zëvendësdrejtor i përgjithshëm, për të ushtruar kompetencat për mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, deri në emërimin e drejtorit të përgjithshëm"; të nenit 18; pika 2, të rregullores "Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave", të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 3.11.2014, si dhe me propozim të zëvendësdrejtorit të përgjithshëm, Këshilli Drejtues

VENDOSI:

1. Anëtarësimin e Bankës Jet sh.a. në skemën e sigurimit të depozitave, si dhe dhënien e certifikatës për sigurimin e depozitave.

2. Autorizohet kryetari i Këshillit Drejtues dhe zëvendësdrejtori i përgjithshëm për nënshkrimin e certifikatës për sigurimin e depozitave në Bankën Jet sh.a.

3. Autorizohet zëvendësdrejtori i përgjithshëm për njoftimin e Bankës Jet sh.a. për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave dhe për dorëzimin e certifikatës për sigurimin e depozitave, si dhe të informojë Autoritetin Mbikëqyrës mbi këtë vendim.

4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare, shpallet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, si dhe në një gazetë kombëtare.

5. Ngarkohet Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Donald Duraj

VENDIM
Nr. 131, datë 13.3.2026

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE "MBËSHTETJE ME GRANTE PËR ZHVILLIMIN TË QËNDRUESHËM NË FUSHAT E RICIKLIMIT, ENERGJISË SË PASTËR, REDUKTIMIT TË NDOTJES DHE EDUKIMIT MJEDISOR NË BASHKINË TIRANË"

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Znj. Delina Ibrahimaj kryetare;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Z. Besnik Çina anëtar;
- Znj. Keida Qirko anëtare;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar,

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 13.3.2026, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, "Për miratimin e rregullores 'Për procedurat dhe formën e njoftimit'", shqyrtoi njoftimin e Bashkisë Tiranë lidhur me skemën e mbështetjes me grante për zhvillimin e qëndrueshëm në fushat e riciklimit, energjisë së pastër, reduktimit të ndotjes dhe edukimit mjedisor në Bashkinë Tiranë.

I. Procedura

1. Bashkia Tiranë me shkresën nr. 5231, datë 5.2.2026, "Kërkesë për miratimin e autorizimit të ndihmës shtetërore për grantin e Bashkisë Tiranë, me titull 'Mbështetje financiare për grante për zhvillim, të qëndrueshëm në fushat e riciklimit, energjisë së pastër, reduktimit të ndotjes dhe edukimit mjedisor", në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, njoftoi në Komisionin e Ndihmës Shtetërore planin e ndihmës shtetërore e sipërpërmendur. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit me shkresën nr. 1103/1, datë 16.2.2026, i kërkoi Bashkisë Tiranë rishikimin e njoftimit. Me shkresën nr. 5231/2, datë 24.2.2026, Bashkia Tiranë dërgoi të rishikuar dhe të plotësuar formularin e njoftimit.

II. Përshkrimi i masës

2. *Objektivi*: Skema synon mbështetjen financiare për zhvillim të qëndrueshëm të mbrojtjes së mjedisit në nivel lokal. Skema ka për qëllim reduktimin, ripërdorimin, riciklimin dhe nxitjen e ekonomisë qarkulluese, nëpërmjet mbështetjes së iniciativave që promovojnë ndarjen në burim të mbetjeve, riciklimin, ripërdorimin dhe reduktimin e konsumit të plastikës dhe të produkteve të tjera bazë. Skema synon promovimin e energjive të pastra dhe eficiencës energjetike, si edhe ruajtjen e biodiversitetit lokal.

3. *Baza ligjore e planit të ndihmës:* vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 100, datë 18.12.2025, "Për miratimin e programit buxhetor 2026–2028, dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026".

4. *Kohëzgjatja:* Plani i ndihmës do të zbatohet në periudhën 2026–2028.

5. *Dhënësi i ndihmës* dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Bashkia Tiranë.

6. *Përfituesit:* Përfituesit e kësaj skeme janë ndërmarrjet mikro dhe të vogla.

7. *Shtrirja sektoriale dhe territoriale:* Projekti do të zbatohet në territorin e Bashkisë Tiranë.

8. *Forma dhe vlera e ndihmës:* Plani i ndihmës shtetërore është 90.000.000 (nëntëdhjetë milionë) lekë gjithsej për periudhën 2026–2028 në formën e grantit të drejtpërdrejtë nga fondet e miratuara për Bashkinë Tiranë. Çdo përfitues do të mbështetet deri në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë, për individë të cilët kanë një ide për të krijuar një biznes miqësor ndaj mjedisit dhe deri në 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për një biznes ekzistues.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

9. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore në kuptim të paragrafi 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

10. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, përcakton se:

"Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore".

11. Gjithashtu, neni 71, "*Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike",* i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropianë e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë[2], përcakton se:

"*Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës së aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit."*

12. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) përzgjedhja; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

13. Plani i ndihmës përfshin transferimin e burimeve shtetërore nga buxheti i Bashkisë Tiranë bazuar në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 100, datë 18.12.2025, "Për miratimin e programit buxhetor 2026–2028, dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026". Masa u jep përfituesve një avantazh ekonomik, që nuk do të sigurohej në kushte normale të tregut. Bashkia Tiranë ofron grante nga buxheti përfshirë blerjen/ instalimin e pajisjeve me energji të rinovueshme. Mbështetja lehtëson ndërmarrjet përfituese nga kostot që në kushte normale të tregut duhet t'i përballojnë me burime të veta, duke u dhënë një avantazh ekonomik. Ndihma mbështet një grup të caktuar prodhuesish/ shërbimesh, duke i dhënë masës karakterin përzgjedhës. Ndihma shtetërore ka potencial të shtrembërojë ose të kërcënojë të shtrembërojë konkurrencën dhe të ndikojë në tregtinë rajonale, apo ndërkombëtare, përmes forcimit të pozicionit konkurrues të ndërmarrjeve me vendndodhje në Bashkinë Tiranë.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se, në bazë të nenit 4, të ligjit 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, plani i ndihmës është ndihmë shtetërore, e cila është e ndaluar përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

14. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në përputhje me nenin 13/1 "Ndihma për mbrojtjen e mjedisit", të ligjit nr. 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar. Në ndihmën për mbrojtjen e mjedisit përfshihen eficienca e energjisë, prodhimi nga burimet e rinovueshme, riciklimi i mbetjeve dhe rehabilitimi i zonave të ndotura. Bazuar në pikën 2, të nenit 13/1, të ligjit nr. 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, ndihma shtetërore lejohet në përputhje me kushtet dhe intensitetet e përcaktuara në VKM-në nr. 513, datë 4.9.2018, "Për miratimin e rregullores 'Për

[2] Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare".

kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore"'.

Mbështetur në seksionin V "Ndihma për mbrojtjen e mjedisit", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 4.9.2018, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore"', përcaktohet se nëse plotësohen kushtet e kreut II, dhe neneve të rregullores mund të lejohet ndihma shtetërore për kategoritë e ndihmës si vijon:

Mbi ndihmën për eficiencën e energjisë (neni 28): Ndihma synon t'u mundësojë ndërmarrjeve arritjen e një niveli më të lartë të eficiencës energjetike. Kostot e pranueshme kufizohen në kostot shtesë të investimit, të nevojshme për të arritur këtë nivel, duke përjashtuar shpenzimet që nuk lidhen drejtpërdrejt me kursimin e energjisë. Intensiteti i ndihmës prej 30% (i rritur sipas madhësisë së ndërmarrjes ose zonës së asistuar) konsiderohet në përputhje me kufijtë maksimalë të lejuar.

Mbi investimet në energjinë e rinovueshme (neni 29): Ndihma jepet vetëm impianteve të reja, në përputhje me pikën 4, të nenit 29. Kostot e pranueshme llogariten si kosto shtesë krahasuar me një investim më pak miqësor ndaj mjedisit. Për rastet e impianteve të vogla ku nuk ekziston një investim i ngjashëm më pak miqësor, Komisioni pranon si kosto të pranueshme kostot totale të investimit, duke aplikuar intensitetin prej 30% ose 45% .

Mbi riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve (neni 32): Ndihma për riciklimin synon mbetjet e prodhuara nga ndërmarrje të tjera dhe përdor teknologji që shkojnë përtej standardeve bazë të tregut. Kostot e pranueshme përfaqësojnë diferencën mes këtij investimi dhe një procesi tradicional riciklimi. Ndihma nuk zbatohet për mbetjet e vetë përfituesit, duke garantuar që skema të nxisë ekonominë qarkulluese.

Mbi Studimet Mjedisore (neni 34): Në ndihmën për studimet mjedisore, kostot e pranueshme janë kosto direkte të realizimit të studimeve që u paraprijnë investimeve mjedisore. Intensiteti prej 50% (me rritjet përkatëse për SME-të) vlerësohet sipas nenit 34, nëse nxit ndërmarrjet të kryejnë vlerësime teknike profesionale para angazhimit në projekte të mëdha mjedisore.

Në kreun II, të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore"', përcaktohet, se:

- Ndihma konsiderohet transparente kur jepet në formën e grantit etj., kur Ekuivalenti Bruto i Grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi përpara dhënies së saj. Ky kusht përmbushet sepse ndihma është në formën e grantit. Bashkia Tiranë do të llogarisë EBG-në për çdo përfitues përpara dhënies së ndihmës.

- Ndihma shtetërore ka efekt nxitës kur përfituesi ka dorëzuar një aplikim me shkrim pranë dhënësit përpara fillimit të punimeve të projektit. Ky aplikim përmban të gjithë informacionin e detyrueshëm: emrin/madhësinë e ndërmarrjes, përshkrimin dhe vendndodhjen e projektit, listën e kostove dhe shumën e fondit publik të kërkuar. Ky kusht plotësohet sepse përfituesi duhet të dorëzojë aplikimin me shkrim pranë dhënësit të ndihmës.

- Të gjitha vlerat e përdorura për kostot e pranueshme llogariten para zbritjes së taksave, apo detyrimeve të tjera. Kostot mbështeten në dokumentacion justifikues të qartë dhe të përditësuar. Ky kusht plotësohet sepse kostot e pranueshme llogariten para zbritjes së taksave.

- Ndihma shtetërore për këtë skemë mund të mblidhet me ndihma të tjera vetëm nëse ato mbulojnë kosto të ndryshme të identifikueshme. Në rastet kur mbulojnë të njëjtat kosto, shuma totale e mbledhur nuk tejkalon intensitetin maksimal të lejuar nga kjo rregullore. *Ndihma nuk mblidhet me ndihmë "de minimis" për të njëjtat kosto nëse kalohet pragu i intensitetit të kreut III.* Ky kusht plotësohet, sepse ndihma shtetërore për këtë skemë do të mblidhet me ndihma të tjera vetëm nëse ato mbulojnë kosto të ndryshme të identifikueshme.

- Dhënësi i ndihmës është i detyruar të publikojë në faqen zyrtare informacionin përmbledhës, tekstin e plotë të masës. Ky informacion duhet të publikohet brenda 6 muajve dhe të ruhet për një periudhë 10-vjeçare nga data e dhënies së ndihmës. Ky kusht plotësohet sepse skema do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë.

Sa më lart, Komisioni vlerëson, se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm në përputhje

me nenin 13/1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 13/1, 22, dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë planin e ndihmës shtetërore "Mbështetje me grante për zhvillimin të qëndrueshëm në fushat e riciklimit, energjisë së pastër, reduktimit të ndotjes dhe edukimit mjedisor në Bashkinë Tiranë", të miratuar më vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 100, datë 18.12.2025, "Për miratimin e programit buxhetor 2026–2028, dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026".

2. Në përputhje me seksionin V, të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore'", Bashkia Tiranë të identifikojë kostot e pranueshme të ndihmës shtetërore dhe mbi bazën e tij të përcaktohet intensiteti i ndihmës së lejuar të skemës së ndihmës shtetërore.

3. Ndihma shtetërore nuk do të mblidhet me ndihmën *"de minimis"* për të njëjtat kosto nëse kalohet pragu i intensitetit të kreut III, të VKM-së nr. 513, datë 4.9.2018, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore'".

4. Bashkia Tiranë, brenda datës 31 mars, të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe impaktin ekonomik të skemës.

5. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

6. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE

Kryetar: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Besnik Çina, Keida Qirko, Ahmet Mançellari

VENDIM
Nr. 46, datë 17.2.2026

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "DEVOLL HYDROPOWER" SHA NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "ç" të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "d", 5, pika 1, germa "d", 13 dhe 16, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.2.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 134/3 prot., datë 13.2.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Devoll Hydropower' sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 81, datë 9.6.2016, dhe i është rinovuar licenca me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 134, datë 7.6.2021, me afat vlefshmërie deri më 10.6.2026.

- Ajo ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 2825/1 prot., datë 10.12.2025, brenda afatit të përcaktuar nga rregullorja.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 335, datë 18.12.2025, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.12.2025 dhe 22.12.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve, apo objeksioneve nga të tretët (data 29.12.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Gjithashtu, njoftimi për fillimin e procedurës u

botua në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 2825/4 prot., datë 24.12.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës, si dhe i ka bërë me dije informacionin /dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 20 prot., datë 6.1.2026, shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion plotësues, nga shqyrtimi i të cilit rezultoi se kishte ende dokumentacion që nevojitej të plotësohej, në lidhje me vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve ndaj organeve tatimore, mbështetjen financiare dhe planin e biznesit, ndaj Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 7, datë 15.1.2026, vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike.

- ERE, me shkresën nr. 134/2 prot., datë 22.1.2026, i është drejtuar shoqërisë duke i kërkuar depozitimin e dokumentacionit të munguar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 20/1 prot., datë 10.2.2026, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacion e munguar të aplikimit.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria disponon aktualisht zyrat përfaqësuese të furnizuesit, por duke qenë se afati i kontratës së qirasë përfundon më 31 mars 2026 dhe nuk mbulon afatin 5-vjeçar të licencës, vlerësohet t'i lihet kusht shoqërisë, që brenda kësaj date të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.

- Për sa dokumentuar nga shoqëria, shlyerja e detyrimeve tatimore është pjesë e një shqyrtimi gjyqësor që ndodhet në proces, ndaj vlerësohet që shoqërisë t'i lihet kusht për depozitimin e vendimit të gjykatës në lidhje me këtë çështje, sapo ta disponojë atë.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit, si dhe ka plotësuar dokumentacionin tjetër në zbatim të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 343, seria F16/F21, të shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 81, datë 9.6.2016, dhe rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 134, datë 7.6.2021, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 11.6.2026.

2. Brenda datës 31.3.2026, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.

3. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrimet tatimore menjëherë sapo ta disponojë atë.

4. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 3.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqëritë "Devoll Hydropower" sh.a., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 47, datë 17.2.2026

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT" SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "e", 5, pika 1, germa "e", 13 dhe 16, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.2.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 66/6 prot., datë 17.2.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Tirana International Development' sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Tirana International Development" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 24.6.2021, me afat vlefshmërie deri më 24.6.2026.

- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 2983/1 prot., datë 24.12.2025, brenda afatit të përcaktuar nga Rregullorja.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 1, datë 8.1.2026, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 9.1.2026 dhe 10.1.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 19.1.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Gjithashtu, njoftimi për fillimin e procedurës u botua në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 66/1 prot., datë 15.1.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për licencimin e saj si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 66/2 prot., datë 22.1.2026, shoqëria ka depozituar informacion/dokumentacion plotësues për aplikimin, nga analizimi i të cilit rezultoi se shoqëria kishte ende dokumentacion që nevojitej të plotësohej. Për rrjedhojë, me *email*-in me nr. 66/3 prot., datë 29.1.2026, ERE i kërkoi shoqërisë depozitimin e këtij dokumentacioni.

- Me qëllim për t'i dhënë mundësi shoqërisë që të depozitojë këtë dokumentacion, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 27, datë 4.2.2026, vendosi të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për kërkesën e shoqërisë "Tirana International Development" sh.p.k. për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike.

- Së fundi, nëpërmjet *email*-it të protokolluar në ERE me nr. 66/5 prot., datë 4.2.2026, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacion e munguar të aplikimit.

- Nga analizimi i aplikimit rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, ka shlyer pagesat e rregullimit dhe, gjithashtu, ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën me nr. 490, seria T21, të shoqërisë "Tirana International Development" sh.p.k., për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 24.6.2021, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 25.6.2026.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqëritë "Tirana International Development" sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 48, datë 17.2.2026

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 30, DATË 4.2.2026, "MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË 'BREÇANI - R.O.S.P' SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 9, DATË 21.1.2022"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; neneve 7, 8 dhe 9 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453/1 prot., datë 13.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, "Mbi përfundimin e procedurave administrative të nisura për heqjen e licencave të shoqërive 'Breçani R.O.S.P' sh.p.k., 'Gerti' sh.p.k., 'Mountain's Green Energy' sh.p.k. dhe 'Tirana Energji' sh.p.k."',

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 30, datë 4.2.2026, ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 497, seria P22, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Breçani - R.O.S.P" sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.1.2022.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare të ERE-s, rezulton se shoqëria e ka shlyer plotësisht debinë e saj brenda afatit 30-ditor të fillimit të procedurës për heqjen e licencës së saj.

- Në nenin 9, germa "a", të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", parashikohet se: "Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas neneve 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës".

- Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të kësaj dispozite, është bërë i pamundur, për shkak të ndryshimit të rrethanave të faktik, konkretisht shlyerjes së plotë të detyrimit financiar nga ana e shoqërisë "Brecani R.O.S.P" sh.p.k. Vërtetimi i pagesës së prapambetur konfirmon se nuk ekzistojnë kushtet që çuan në nisjen e procedurës për heqjen e licencës, pasi objekti për të cilin është nisur kjo procedurë nuk ekziston më.

- Në këto kushte, vlerësohet përfundimi i procedurës për heqjen e licencës dhe shfuqizimi i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 30, datë 4.2.2026.

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 30, datë 4.2.2026, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 497, seria P22, në veprimtarinë e

prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Brecani R.O.S.P" sh.p.k." me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.1.2022".

2. Të shfuqizojë vendimin e Bordit nr. 30, datë 4.2.2026.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Breçani - R.O.S.P" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 49, datë 17.2.2026

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 32, DATË 4.2.2026, "MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË 'GERTI' SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 99, DATË 16.4.2021"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 95 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; neneve 7, 8 dhe 9, të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453/1 prot., datë 13.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, "Mbi përfundimin e procedurave administrative të nisura për heqjen e licencave të shoqërive, 'Breçani R.O.S.P' sh.p.k., 'Gerti' sh.p.k., 'Mountain's Green Energy' sh.p.k. dhe 'Tirana Energji' sh.p.k.",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 32, datë 4.2.2026, ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 489, seria P21, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Gerti" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare të ERE-s, rezulton se shoqëria e ka shlyer plotësisht debinë e saj brenda afatit 30-ditor të fillimit të procedurës për heqjen e licencës së saj.

- Në nenin 9, germa "a", të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", parashikohet, se: "Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas neneve 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës".

- Në nenin 95 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", parashikohet, se: "Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura, apo qëllimi i tij është bërë i pamundur".

- Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të kësaj dispozite, është bërë i pamundur, për shkak të ndryshimit të rrethanave të faktik, konkretisht shlyerjes së plotë të detyrimit financiar nga ana e shoqërisë "Gerti" sh.p.k. Vërtetimi i pagesës së prapambetur konfirmon se nuk ekzistojnë kushtet që çuan në nisjen e procedurës për heqjen e licencës, pasi objekti për të cilin është nisur kjo procedurë nuk ekziston më.

- Në këto kushte, vlerësohet përfundimi i procedurës për heqjen e licencës dhe shfuqizimi i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2026.

Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2026, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 489, seria P21, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Gerti" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021".

2. Të shfuqizojë vendimin e bordit nr. 32, datë 4.2.2026.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "Gerti" sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 50, datë 17.2.2026

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 33, DATË 4.2.2026, "MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË 'GERTI' SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 362, DATË 7.12.2023"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 95 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; neneve 7, 8 dhe 9 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453/1 prot., datë 13.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, "Mbi përfundimin e procedurave administrative të nisura për heqjen e licencave të shoqërive, 'Breçani R.O.S.P' sh.p.k., 'Gerti' sh.p.k., 'Mountain's Green Energy' sh.p.k. dhe 'Tirana Energji' sh.p.k.",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 33, datë 4.2.2026, ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 570 seria P23, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Gerti" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 362, datë 7.12.2023.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare të ERE-s, rezulton se shoqëria e ka shlyer plotësisht debinë e saj brenda afatit 30-ditor të fillimit të procedurës për heqjen e licencës së saj.

- Në nenin 9, germa "a", të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", parashikohet, se: "Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas neneve 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës".

- Në nenin 95 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", parashikohet, se: "Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur".

- Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të kësaj dispozite, është bërë i pamundur, për shkak të ndryshimit të rrethanave të faktik, konkretisht shlyerjes së plotë të detyrimit financiar nga ana e shoqërisë "Gerti" sh.p.k. Vërtetimi i pagesës së prapambetur konfirmon se nuk ekzistojnë kushtet që çuan në nisjen e procedurës për heqjen e licencës, pasi objekti për të cilin është nisur kjo procedurë nuk ekziston më.

- Në këto kushte, vlerësohet përfundimi i procedurës për heqjen e licencës dhe shfuqizimi i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 33, datë 4.2.2026. Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 33, datë 4.2.2026, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 570, seria P23, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë 'Gerti' sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 362, datë 7.12.2023".

2. Të shfuqizojë vendimin e bordit nr. 33, datë 4.2.2026.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Gerti" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 51, datë 17.2.2026

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 34, DATË 4.2.2026, "MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË 'GERTI' SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 54, DATË 22.2.2021"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 95 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; neneve 7, 8 dhe 9 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453/1 prot., datë 13.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, "Mbi përfundimin e procedurave administrative të nisura për heqjen e licencave të

shoqërive, 'Breçani R.O.S.P' sh.p.k., 'Gerti' sh.p.k., 'Mountain's Green Energy' sh.p.k. dhe 'Tirana Energji' sh.p.k.",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 34, datë 4.2.2026, ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 484, seria T21, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Gerti" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 54, datë 22.2.2021.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare të ERE-s, rezulton se shoqëria e ka shlyer plotësisht debinë e saj brenda afatit 30-ditor të fillimit të procedurës për heqjen e licencës së saj.

- Në nenin 9, germa "a", të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", parashikohet, se: "Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës".

- Në nenin 95 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", parashikohet, se: "Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur".

- Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të kësaj dispozite, është bërë i pamundur, për shkak të ndryshimit të rrethanave të faktik, konkretisht shlyerjes së plotë të detyrimit financiar nga ana e shoqërisë "Gerti" sh.p.k. Vërtetimi i pagesës së prapambetur konfirmon se nuk ekzistojnë kushtet që çuan në nisjen e procedurës për heqjen e licencës, pasi objekti për të cilin është nisur kjo procedurë nuk ekziston më.

- Në këto kushte, vlerësohet përfundimi i procedurës për heqjen e licencës dhe shfuqizimi i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 34, datë 4.2.2026. Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë, apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 34, datë 4.2.2026, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 484, seria T21, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë 'Gerti' sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 54, datë 22.2.2021".

2. Të shfuqizojë vendimin e bordit nr. 34, datë 4.2.2026.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Gerti" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 52, datë 17.2.2026

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 38, DATË 4.2.2026, "MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË 'MOUNTAIN'S GREEN ENERGY' SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 283, DATË 18.12.2024"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 95 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; neneve 7, 8 dhe 9 të rregullores "Për

procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453/1 prot., datë 13.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, "Mbi përfundimin e procedurave administrative të nisura për heqjen e licencave të shoqërive, 'Breçani R.O.S.P' sh.p.k., 'Gerti' sh.p.k., 'Mountain's Green Energy' sh.p.k. dhe 'Tirana Energji' sh.p.k.",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 38, datë 4.2.2026, ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 602, seria P24, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Mountain's Green Energy" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 283, datë 18.12.2024.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare të ERE-s, rezulton se shoqëria e ka shlyer plotësisht debinë e saj brenda afatit 30-ditor të fillimit të procedurës për heqjen e licencës së saj.

- Në nenin 9, germa "a", të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", parashikohet, se: "Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës".

- Në nenin 95 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", parashikohet, se: "Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur".

- Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të kësaj dispozite, është bërë i pamundur, për shkak të ndryshimit të rrethanave të faktik, konkretisht shlyerjes së plotë të detyrimit financiar nga ana e shoqërisë "Mountain's Green Energy" sh.p.k. Vërtetimi i pagesës së prapambetur konfirmon se nuk ekzistojnë kushtet që çuan në nisjen e procedurës për heqjen e licencës, pasi objekti për të cilin është nisur kjo procedurë nuk ekziston më.

- Në këto kushte, vlerësohet përfundimi i procedurës për heqjen e licencës dhe shfuqizimi i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 38, datë 04.02.2026. Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë, apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 38, datë 4.2.2026, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 602, seria P24, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë 'Mountain's Green Energy' sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 283, datë 18.12.2024".

2. Të shfuqizojë vendimin e bordit nr. 38, datë 4.2.2026.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Mountain's Green Energy" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 53, datë 17.2.2026

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 40, DATË 4.2.2026, "MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË 'TIRANA ENERGJI' SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 21, DATË 4.11.2020"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 95 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; neneve 7, 8 dhe 9 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 453/1 prot., datë 13.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës, "Mbi përfundimin e procedurave administrative të nisura për heqjen e licencave të shoqërive, 'Breçani R.O.S.P' sh.p.k., 'Gerti' sh.p.k., 'Mountain's Green Energy' sh.p.k. dhe 'Tirana Energji' sh.p.k.",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 40, datë 4.2.2026, ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 119, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Tirana Energji" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 4.11.2020.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare të ERE-s, rezulton se shoqëria e ka shlyer plotësisht debinë e saj brenda afatit 30-ditor të fillimit të procedurës për heqjen e licencës së saj.

- Në nenin 9, germa "a", të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", parashikohet, se: "Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenet 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës".

- Në nenin 95 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", parashikohet, se: "Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur".

- Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të kësaj dispozite, është bërë i pamundur, për shkak të ndryshimit të rrethanave të faktik, konkretisht shlyerjes së plotë të detyrimit financiar nga ana e shoqërisë "Tirana Energji" sh.p.k. Vërtetimi i pagesës së prapambetur konfirmon se nuk ekzistojnë kushtet që çuan në nisjen e procedurës për heqjen e licencës, pasi objekti për të cilin është nisur kjo procedurë nuk ekziston më.

- Në këto kushte, vlerësohet përfundimi i procedurës për heqjen e licencës dhe shfuqizimi i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 40, datë 4.2.2026. Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 4.2.2026, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 119, seria PV11K, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Tirana Energji" sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21 datë 4.11.2020".

2. Të shfuqizojë vendimin e Bordit nr. 40, datë 4.2.2026.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Tirana Energji" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 54, datë 17.2.2026

MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 304, DATË 17.11.2025, "MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË 'PROINFINIT CONSULTING' SHPK

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.2.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 450/1 prot., datë 13.2.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Proinfinit Consulting' sh.p.k. për shfuqizimin e vendimit të Bordit nr. 304, datë 17.11.2025",

Konstatoi se:

- Shoqëria "Proinfinit Consulting" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 6.6.2023, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 6.6.2023.

- Me shkresën nr. 2796 prot., datë 5.11.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion në lidhje me marrjen e autorizimit nga ERE për miratimin e ndryshimit të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 304, datë 17.11.2025, vendosi të japë autorizimin për ndryshimin e ortakëve që kontrollojnë interesat e shoqërisë "Proinfinit Consulting" sh.p.k. Ortakët e shoqërisë ndryshojnë dhe bëhen Z. A G dhe Z. E K, ku Z. A G bëhet ortaku kryesor që kontrollon interesat e saj (me 65% të kuotave të kapitalit).

- Në vijim, shoqëria, me shkresën nr. 450 prot., datë 2.2.2026, ka paraqitur kërkesën për shfuqizimin e vendimit nr. 304/2025, duke sqaruar se kuotat nuk janë transferuar te Z. A G dhe Z. E K, për arsye të prishjes së marrëveshjes së shitblerjes mes palëve.

- Nga verifikimi i ekstraktit historik të shoqërisë rezulton se nuk është bërë asnjë kalim/ndryshim kuotash, çka përputhet me sa deklaruar nga shoqëria se nuk ka ndodhur asnjë ndryshim në vijim të vendimit 304/2025.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë vendimin nr. 304, datë 17.11.2025, "Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut, që kontrollon interesat e shoqërisë "Proinfinit Consulting" sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Proinfinit Consulting" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 55, datë 17.2.2026

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "3AD ENERGY" SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE SI MJET PËR GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË DETYRIMIT NDAJ "FIRST INVESTMENT BANK" SHA

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 3 dhe 8 të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.2.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 317/3 prot., datë 13.2.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, "Mbi kërkesën e shoqërisë '3AD Energy' sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj 'First Investment Bank' sh.a.",

konstatoi se,

- Shoqëria "3AD Energy" sh.p.k., është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 1, datë 6.1.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Me shkresën nr. 317 prot., datë 23.1.2026, shoqëria ka paraqitur aplikim dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse "First Investment Bank" (FiBank) sh.a.

- Në kuadër të kësaj kërkese dhe në mbështetje të dispozitave të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, shoqëria ka depozituar, ndër të tjera: Kontratën e Kredisë Bankare nr. 4023 rep., nr. 1278 kol., datë 4.10.2024 dhe marrëveshjen siguruese nr. 4034 kol., nr. 1284 rep., datë 4.10.2024, ku citohet vendosja e pengut mbi 100% të kuotave të kredimarrësit.

- Konstatohet se si kontrata e kredisë, ashtu dhe marrëveshja siguruese rezultojnë të nënshkruara përpara se shoqëria të ishte licencuar nga ERE, pra përpara se shoqërisë t'i lindte detyrimi për të marrë autorizimin e ERE-s për këtë barrësim.

- ERE, me shkresën nr. 317/1 prot., datë 2.2.2026 dhe *email*-in e datës 12.2.2026, i ka kërkuar shoqërisë të informojë nëse është nënshkruar ndonjë marrëveshje siguruese vijuese me bankën pas licencimit në lidhje me barrësimin e kuotave.

- Në përgjigje me shkresën nr. 317/2 prot., datë 12.2.2026, shoqëria bëri me dije, se, përveç kontratës së kredisë bankare dhe marrëveshjes siguruese, të cilat janë vënë në dispozicion në kuadër të aplikimit, i licencuari, shoqëria "3AD Energy" sh.p.k. nuk ka nënshkruar asnjë marrëveshje tjetër me bankën në lidhje me barrësimin e kuotave.

- Si e tillë, vlerësohet se ERE nuk mund të marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë për sa kohë marrëdhënia juridike me bankën për vendosje barrë siguruese është krijuar përpara se shoqëria të merrte statusin e të licencuarit dhe të lindnin detyrimet përkatëse në kuadër të këtij statusi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë "3AD Energy" sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të

kapitalit si mjet për garantimin e detyrimeve ndaj "First Investment Bank" sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "3AD Energy" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 69, datë 10.3.2026

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN SHKURT 2026, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.3.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 793/1 prot., datë 6.3.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2026 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV",

konstatoi se:

I. Aspektet ligjore dhe procedurale

1. Paraqitja e kërkesës nga FSHU sh.a.

- Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën nr. 1257 prot., datë 2.3.2026, protokolluar në ERE me nr. 793 prot., datë 3.3.2026, ka depozituar kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin shkurt 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE

Kërkesa është shqyrtuar në përputhje me nenin 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe "Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar.

II. Analiza e përllogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV

1. Blerja e energjisë në bursë

Për muajin shkurt 2026, shoqëria FSHU sh.a. ka siguruar sasinë e energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji të kësaj kategorie klientësh nëpërmjet blerjeve ditore/mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).

2. Përllogaritja e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes (ÇBEt)

Referuar të dhënave të paraqitura, rezulton se çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) i përllogaritur nga shoqëria për muajin shkurt 2026 është 5.92 lekë/kwh. Për efekt kontrolli të të dhënave të paraqitura, u konsiderua e arsyeshme rillogaritja e tyre, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 5.92 lekë/kwh, sikurse pasqyruar edhe në përllogaritjet e përcjella nga vetë shoqëria.

3. Komponentët sipas metodologjisë (neni 8, vendimi nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar)

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë, si më poshtë:

- Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) për muajin shkurt 2026: 5.92 lekë/kwh;

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025–31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 279, datë 16.12.2024: 0.85 lekë/kwh;

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, sipas vendimit të bordit të ERE nr. 312, datë 12.12.2025, "Mbi lënien në fuqi deri më 30 prill 2026 të tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike", të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022": 1.55 lekë/kwh;

- Kostot administrative: 1.06 lekë/kwh;

- Kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë (lekë/euro), për çdo datë respektive të harkut kohor 30.1.2026–27.2.2026.

- Në zbatim të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2026, përllogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin shkurt 2026

		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	5.92
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.18
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA		**Lekë/kWh**	**9.56**

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit rezulton 9.56 lekë/kwh për muajin shkurt 2026.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2026 prej 9.56 lekësh/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategorinë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 70, datë 10.3.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "GSA" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "e", 5, pika 1, germa "e", dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të rregullores "Për organizimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 275/4 prot., datë 6.3.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'GSA' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "GSA" sh.p.k., në datën 26.2.2026 ka paraqitur aplikimin për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe ka kryer pagesën që i korrespondon këtij aplikimi, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

- Në vlerësimin e aplikimit për licencim është marrë në konsideratë edhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria në datën 26.1.2026 dhe janë bërë vlerësimet përkatëse në lidhje me afatet respektive të dokumentacionit apo vërtetimeve.

- Në këto rrethana, në rast licencimi të shoqërisë, vlefshmëria e licencës do të fillojë me përfundimin e afatit të licencës aktuale, pra më datë 24.6.2026.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi, rezulton se nga ana e shoqërisë nevojitet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, "Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë"

Pika 1.1: Shoqëria duhet të depozitojë shtojcën 1, të plotësuar në të gjithë zërat e saj, në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin.

Pika 1.2, "Dokumentacioni juridik dhe administrativ":

- Germa "b": shoqëria duhet të depozitojë dëshminë e penalitetit për njërin nga administratorët e saj, pasi rezulton të jetë depozituar jashtë afatit të përcaktuar nga neni 8, pika 3 e rregullores, si dhe të depozitojë dëshminë e penalitetit për administra-torin tjetër, që nuk rezulton të jetë depozituar në dosje.

- Germa "d": shoqëria duhet të depozitojë aktin e përfaqësimit për përfaqësuesin ligjor.

Pika 1.3, "Dokumentacioni financiar dhe fiskal":

- Germa "b": shoqëria duhet të saktësojë/ korrigjojë sasitë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë dhe të depozitojë dokumentacionin vërtetues që provon disponimin e mbështetjes financiare të nevojshme për ushtrimin e të paktën 1 (një) muaj të aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike.

- Germa "c": Shoqëria duhet të saktësojë sasitë e energjisë elektrike për tregtimin në planin e biznesit, në referencë dhe të dokumentacionit tjetër të këtij aplikim, si dhe të përcaktojë mënyrën financimit të veprimtarisë.

Për sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "GSA" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "GSA" sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 72, datë 10.3.2026

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET MARRËVESHJES SIGURUESE) TË ASETEVE FIKSE TË SHOQËRISË "NOVA SOLAR SYSTEM" SHPK, SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ "RAIFFEISEN BANK" SHA

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma "a", dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, gërma "b", 6, 7 dhe 8 të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikave 1.3 dhe 1.6, të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 843 prot., datë 6.3.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Nova Solar System' sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj 'Raiffeisen Bank' sh.a.",

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë "Nova Solar System" sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria "Nova Solar System" sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 3.8.2023.

- Me shkresën nr. 62/1 prot., datë 19.1.2026 shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve të saj, si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj "Raiffeisen Bank" sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 29, datë 4.2.2026, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë.

- ERE, me shkresën nr. 54/6 prot., datë 11.2.2026, dhe *email*-in e datës 23.2.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe i ka bërë me dije dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në këtë aplikim. Gjithashtu, në lidhje me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 251/2025, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nëpërmjet shkresës me nr. 585 prot., datë 10.2.2026.

3. Dorëzimi i dokumentacionit plotësues

- Me *email*-in e datës 25.2.2026 dhe me shkresën nr. 62/6, datë 2.3.2026, shoqëria ka përcjellë të plotë dokumentacionin/informacionin e munguar në këtë aplikim.

4. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria "Nova Solar System" sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 4, 6, 7 dhe 8, të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, si vijon:

- Neni 4, germa "b", "Për transferimin e aseteve të të licencuarve me kapacitet te instaluar nën 1 mw", nuk ka nevojë për miratimin e ERE-s. Për të gjithë të licencuarit e tjerë do të kërkohet miratimi i ERE-s për transferim të aseteve, kur vlera e asetit që kërkohet të transferohet është më e madhe se 150.000.000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë.

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 7:

- Pika 1: janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi kërkesën për transferim, ndër të tjera, si më poshtë vijon:

- Germa "a": është depozituar ekstrakti historik i shoqërisë, i vlefshëm brenda afatit ligjor;

- Germa "b": është plotësuar informacioni mbi veprimtarinë e licencuar;

- Germa "c": është plotësuar informacioni mbi gjendjen financiare të kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efekti i pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve;

- Germa "d": është bërë një përshkrim i kandidatit;

- Germa "e", "f" dhe "g": arsyet e kërkesës, efektet në aktivitetin e licencuar dhe furnizimin e klientëve;

- Germa "h": janë depozituar kontratat/ marrëveshjet përkatëse;

- Kontratë kredie me nr. 7303 rep., nr. 3488 kol., datë 6.10.2023, nënshkruar nga palët, që do të përdoret nga kredimarrësi për financimin, në lidhje me investimin në projektin për ndërtimin, instalimin dhe vënien në punë të parkut fotovoltaik 50 mw, si dhe mbylljen e detyrimeve të shoqërisë "Nova Solar System" sh.p.k.

- Kontratë kredie nr. 10975 rep., nr. 4604 kol., datë 19.12.2025, nënshkruar nga palët, që do të përdoret për të financuar kredimarrësin për ndërtimin/instalimin e kapaciteteve magazinuese të energjisë elektrike në bateri, me qëllim magazinimin e energjisë elektrike së prodhuar nga parku fotovoltaik 50 mw.

- Marrëveshje siguruese nr. 10979 rep., nr. 4608 kol., datë 19.12.2025, me anë të së cilës është rënë dakord të vendoset në favor të barrëmarrësit asetet fikse të shoqërisë.

- germa "i": deklarata e kredidhënësit për garantimin e vazhdimësisë së aktivitetit;

- germa "j": deklarata dhe vërtetimi për mungesë transferimesh të mëparshme mbi asetet fikse.

- Pika 3: është plotësuar informacioni i kërkuar në këtë pikë që lidhet me detyrimet me të cilat ngarkohet subjekti për shkak të marrëveshjes së koncesionit në pjesët që transferojnë tek përfituesi përfshirë edhe informimin e Autoriteti Shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve.

- Pika 4: kërkesa për aplikim është nënshkruar nga administratori i shoqërisë, ndërsa dokumentet e tjera shoqëruese të këtij aplikimi janë nënshkruar nga administratori dhe/ose personat e autorizuar sipas rastit.

Pika 6: Shoqëria ka bërë me dije se kërkon që dokumentacioni i këtij aplikimi të mos jetë i hapur për publikun.

- Pavarësisht kërkesës së shoqërisë për konfidencialitetit tërësor të dosjes, ERE, në zbatim të rregullave të mësipërme dhe "Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 26.03.2018, ka kryer shqyrtimin e dokumentacionit për të identifikuar konkretisht pjesët që justifikojnë trajtimin si konfidencial, duke zbatuar parimin e kufizimit proporcional (pra, klasifikim vetëm për ato pjesë ku ka bazë ligjore dhe nevojë reale për mbrojtje).

- Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar, duke qenë se përmbajnë të dhëna identifikuese të personave fizikë, si dhe informacione të aktivitetit tregtare, justifikojnë trajtimin si konfidencial, dokumentacioni si vijon:

1. Shkresa e shoqërisë "Nova Solar System" sh.p.k. e datës 19.1.2026, kërkesë për dhënien a autorizimit për vendosjen e aseteve si barrë siguruese. (Do të konsiderohen konfidenciale të dhënat personale të administratorit, si dhe informacione të aktivitetit tregtar të shoqërisë.)

2. Deklarata e bankës "Raiffeisen Bank" sh.a. e datës 26.2.2026, mbi përshkrimin e aktivitetit të saj. (Ky dokument do të konsiderohet si konfidencial duke qenë se përmban informacione të aktivitetit tregtar të bankës dhe të dhëna sensitive që mund të konsiderohen si sekret tregtar.)

3. Kontrata e Kredisë Bankare nr. 7303 rep., nr. 3488 kol., datë 6.10.2023 dhe Kontrata e Kredisë Bankare me nr. 10975 rep., nr. 4604 kol., datë 19.12.2025 (Këto dokumente do të konsiderohen si konfidencial, duke qenë se ajo përmban termat e një marrëdhënieje garancie dhe mund të përfshijë: kushte financimi, detaje të kontratave të kredisë, risk kreditor, klauzola sigurimi, detyrime të palëve, të cilat janë të dhëna me natyrë ekonomike/ kontraktuale që mund të dëmtojnë interesat e subjektit/ palëve të treta nëse publikohen.)

- Nga ana tjetër, do të konsiderohen dhe trajtohen si jokonfidencial, për arsye se janë dokumente me karakter deklarativ/informues dhe/ose janë të depozituara apo të aksesueshme pranë institucioneve publike kompetente, dokumentacioni si vijon:

1. Ekstrakti i regjistrit tregtar i shoqërisë "Nova Solar System" sh.p.k. (Ky dokument do të konsiderohet si jokonfidencial, në rrethanat kur është i publikuar dhe i aksesueshëm pranë institucioneve publike kompetente, në rastin konkret Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).)

2. Marrëveshje siguruese nr. 10979 rep., nr. 4608 kol., datë 19.12.2025. (Marrëveshja Siguruese do të konsiderohet jokonfidenciale (pasi këto marrëveshje publikohen në QKB), por me

redaktim selektiv të elementeve që përbëjnë të dhëna financiare sensitive dhe të dhëna personale.)

3. Deklarata e administratorit e 27.2.2026, ku shprehet se nuk janë kryer transferime të aseteve të shoqërisë më herët, si dhe shkresa e shoqërisë me nr. 129 prot., datë 17.2.2026, për plotësimin e dokumentacionit të munguar (Këto dokumente përbëjnë akte të brendshme deklarative, dhe nuk përmbajnë në vetvete sekret tregtar apo informacion financiar të ndjeshëm, ndaj konsiderohen dokumente me natyrë jokonfidenciale, por me redaktim selektiv të elementeve që përbëjnë të dhëna personale.)

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve fikse të saj (sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi), si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj "Raiffeisen Bank" sh.a., nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

- Për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi asetet e shoqërisë për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi asetet e saj ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë "Nova Solar System" sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet marrëveshjes siguruese) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj "Raiffeisen Bank" sh.a. (për kontratat e kredive nr. 7303 rep., nr. 3488 kol., datë 6.10.2023 dhe nr. 10975 rep., nr. 4604 kol., datë 19.12.2025, si dhe nga marrëveshjen siguruese nr. 10979 rep., nr. 4608 kol., datë 19.12.2025). (Lista e aseteve bashkëlidhur.)

2. Dhënia e autorizimit sipas përcaktimeve të pikës 1 nuk e çliron shoqërinë "Nova Solar System" sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/ miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria "Nova Solar System" sh.p.k. të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi asetet e paluajtshme të saj që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar, ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm, si dhe në rast të çdo ndryshimi në këtë marrëveshje, përfshirë transferimin te të tretët.

4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se shoqëria dokumenton heqjen e barrës siguruese të radhës së parë të vendosur mbi asetet e saj, apo depozitohet ndonjë dokument i ndryshëm nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Nova Solar System" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

ANEKS 1
AKTIVET AFATGJATA MATERIALE ME VLERË FILLESTARE 30.11.2025

- Toka, me vlerë 127,840,738 lekë;
- Mjete transporti, me vlerë 2,767,560 lekë;
- Pajisje informatike, me vlerë 452,761 lekë;
- Të tjera, me vlerë 44,158 lekë;
- Nënstacioni Hoxharë, me vlerë 323,078,727 lekë;
- Main Station, me vlerë 135,723,489 lekë;
- Panele fotovoltaike, me vlerë 1,317,747,626 lekë;

- Inverterat, me vlerë 169,467,386 lekë;
- F.V kamera/ndriçim, me vlerë 77,247,740 lekë;
- Kabina Box, me vlerë 514,948,222 lekë;
- Rrethim kantieri, me vlerë 69,013,267 lekë;
- Punime skarifikimi, me vlerë 154,622,626 lekë;
- Konstruksioni paneleve, me vlerë 491,630,115 lekë.

Vlera totale rezulton 3,384,584,414 (tre miliard e treqind e tetëdhjetë e katër milionë e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e katërmbëdhjetë) lekë.

VENDIM
Nr. 73, datë 10.3.2026

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "EB ENERGY" SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE SI MJET PËR GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË DETYRIMIT NDAJ "PROCREDIT BANK" SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 3 dhe 8 të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave /aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 842 prot., datë 10.3.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'EB Energy' sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj 'ProCredit Bank' sh.a.",

konstatoi se,

- Shoqëria "EB Energy" sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 14.2.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 765 prot., datë 2.3.2026, shoqëria ka paraqitur aplikimin dhe dokumentacionin për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse "ProCredit Bank" sh.a.

- Në kuadër të kësaj kërkese dhe në mbështetje të dispozitave të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave /aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, shoqëria ka depozituar, ndër të tjera: kontratat e kredive bankare, respektivisht me nr. 2958 rep., nr. 1678 kol., datë 23.12.2024 dhe nr. 2959 rep., nr. 1679 kol., datë 23.12.2024, si dhe marrëveshje siguruese (kontratë pengu kuota të shoqërisë) nr. 2960 kol., nr. 1680 rep., datë 23.12.2024, ku dakortësohet vendosja e pengut të 100% të kuotave të kredimarrësit.

- Konstatohet se, si kontratat e kredive, ashtu dhe ajo e pengut, rezultojnë të nënshkruara përpara se shoqëria të ishte licencuar nga ERE, pra përpara se shoqërisë t'i lindte detyrimi për të marrë autorizimin e ERE-s për këtë barrësim.

- Në shkresën përcjellëse, shoqëria bën me dije se garancia do të realizohet përmes vendosjes së pengut mbi kuotat, ku në zbatim të nenit 4, pikat 4.1 dhe 4.2 të kontratës së pengut mbi kuotat, barra e sigurimit konsiderohet e plotë vetëm pas regjistrimit të saj në Regjistrin e Barrëve Siguruese (RBS) dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), dhe nga shoqëria sqarohet se aktualisht procesi i barrës është i pakompletuar, duke qenë se pritet miratimi i ERE-s.

- Për sa analizuar, rezulton se, përveç faktit që kontratat janë nënshkruar përpara se subjekti të kishte marrë statusin si i licencuar, këto kontrata nuk kanë asnjë parashikim që lidhet me fillimin e afateve të tyre, duke referuar detyrimin e marrjes së miratimit nga ERE, kjo evidentuar si e paparashikuar as në kontratat e kredisë e as në

marrëveshjen e nënshkruar të pengut, si kusht i paracaktuar që duhet të plotësohet nga ana e kredimarrësit. Gjithashtu, në aneksin 2, neni 3, pika 3.1 të kontratave të kredisë, citohet se: "Periudha gjatë së cilës kredia është në dispozicion të kredimarrësit për disbursim fillon në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate (23.12.2024) dhe mbaron brenda 30 ditëve", që do të thotë se kjo periudhë ka përfunduar në 23.1.2025, pra, gjithashtu, përpara se shoqërisë t'i lindte detyrimi për të marrë autorizimin në ERE për këtë barrësim.

- Në këto rrethana, vlerësohet se ERE nuk mund të marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë për sa kohë marrëdhënia juridike me bankën është krijuar përpara se shoqëria të merrte statusin e të licencuarit dhe të lindnin detyrimet përkatëse në kuadër të këtij statusi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë "EB Energy" sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të kapitalit si mjet për garantimin e detyrimeve ndaj "ProCredit Bank" sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "EB Energy" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi men jëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 256 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2026/03/31 15:50:21 +02'00'
0399519935d44ff19643e45a6542201a

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)